VENDIM
Nr. 51, datë 21.4.2026

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fiona Papajorgji	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Ilir Toska	anëtar;
Genti Ibrahimi	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Asim Vokshi	anëtar,

me sekretare Farisja Idrizaj, në datën 21.4.2026, mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 20 (Sh) 2025 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Shoqëria "Restur" sh.p.k., përfaqësuar nga avokati Ermir Beta, me autorizim përfaqësimi.

Shoqëria "Mediterranean Investment Group" sh.p.k., përfaqësuar nga avokati Ermir Beta, me autorizim.

Redi Molla, përfaqësuar nga avokatët Ermir Beta dhe Ardian Visha, me prokurë të posaçme.

Ollga Molla, përfaqësuar nga avokati Ermir Beta, me prokurë të posaçme.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, përfaqësuar nga prokurori Klodjan Braho.

Shoqëria "5D Konstruksion" sh.p.k., përfaqësuar nga avokatët Arjan Salati dhe Henrik Ligori, me prokurë të posaçme.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 388, datë 5.7.2024, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 162 (87-2024-219), datë 31.7.2024, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 00-2024-2041 (307), datë 12.12.2024, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 30, 31, shkronja "b", 33, pika 1, 41, 42, 131, pika 1, shkronja "f", dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 5 dhe 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar *(Ligji Organik i Gjykatës)*.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Fiona Papajorgji, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuesve, shoqërisë "Restur" sh.p.k. *(shoqëria "Restur"),* shoqërisë "Mediterranean Investment Group" sh.p.k. *(shoqëria "Mediterranean Investment Group"),* Redi Mollës dhe Ollga Mollës, të cilët kanë kërkuar pranimin e kërkesës, pretendimet me shkrim të subjektit të interesuar, shoqërisë "5D Konstruksion" sh.p.k. (*shoqëria "5D"*), e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të

Organizuar (*Prokuroria e Posaçme*), që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I
Rrethanat e çështjes

1. Prokuroria e Posaçme ka bashkuar dy procedime penale në një të vetme me nr. 75 të vitit 2023, për veprat penale "Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tenderë dhe në ankande publike", "Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike", të parashikuara nga nenet 258, paragrafi i dytë, dhe 259, paragrafi i dytë, të Kodit Penal (*KP*), në ngarkim të disa personave, ndaj të cilëve janë vendosur edhe masa të sigurimit personal, përfshirë kërkuesin Redi Molla. Në datën 4.6.2024, Prokuroria e Posaçme ka regjistruar edhe veprën penale "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale", të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 287/2 dhe 25 të KP-së, duke shënuar, ndër të tjerë, edhe emrin e subjektit të interesuar, shoqërisë "5D", si të dyshuar për kryerjen e kësaj vepre penale.

2. Sipas Prokurorisë së Posaçme, gjatë hetimeve paraprake janë ngritur dyshime se kërkuesi Redi Molla dhe shtetasi M. Q., të cilët kanë ushtruar funksione drejtuese në një ndërmarrje publike në varësi të Bashkisë së Tiranës, janë pronarët *de facto* të subjektit të interesuar, shoqërisë "5D", të regjistruar në regjistrin tregtar më 22.1.2016, që nga momenti i themelimit të saj e në vazhdim. Sipas Prokurorisë së Posaçme, kjo shoqëri është shpallur fituese në disa procedura prokurimi të hapura nga kjo ndërmarrje publike, si autoriteti kontraktor, duke u favorizuar padrejtësisht në garë, ndërkohë që kërkuesi Redi Molla ishte edhe titullari i këtij autoriteti kontraktor. Hetimet janë shtrirë në 7 procedura prokurimi të zhvilluara nga ndërmarrja publike në fjalë, si autoritet kontraktor, dhe në 5 procedura të tjera të shpallura nga Bashkia e Tiranës, si dhe institucionet e tjera në varësi. Hetimet janë shtrirë edhe në drejtim të deklarimeve të pasurisë dhe të interesave të kërkuesit Redi Molla, duke u ngritur dyshimet se ai ka fshehur faktin që ka në zotërim të tërthortë subjektin e interesuar, shoqërinë "5D". Sipas Prokurorisë së Posaçme, prindërit e kërkuesit Redi Molla, i ndjeri S. M. (i ati) dhe kërkuesja Ollga Molla (e ëma), kanë fituar pronësinë mbi dy pasuri të paluajtshme, duke u ngritur dyshimet se financimi i tyre është siguruar pjesërisht nga subjekti i interesuar, shoqëria "5D". Nga të dhënat e regjistrit tregtar, ka rezultuar se kërkuesi Redi Molla është ortak i vetëm dhe administrator i shoqërisë "Restur", përfituar me trashëgimi nga i ati i tij, i cili deri në vitin 2023 ka depozituar në total 566.440 euro në llogarinë e shoqërisë. Kjo shoqëri zotëron edhe një kuotë të barabartë me 24% të kapitalit të shoqërisë "Mediterranean Investment Group". Për këtë të fundit ka realizuar punime ndërtimi subjekti i interesuar, shoqëria "5D", për të cilat është paguar pjesërisht.

3. Në kuadër të këtij procedimi penal, Prokuroria e Posaçme ka paraqitur kërkesë në gjykatë për caktimin e masës së sigurimit pasuror "Sekuestro preventive" për disa pasuri, përfshirë: i. *pasurinë e paluajtshme nr. 5/523,* zona kadastrale nr. 8150, e llojit truall, e ndodhur në Tiranë, e regjistruar në emër të prindërve të kërkuesit Redi Molla (kërkueses Ollga Molla dhe të ndjerit S. M.), si pasuri e përfituar pjesërisht me burime financimi nga shoqëria "5D", burime financimi që rrjedhin nga produkte të veprës penale; ii. *pasurinë e paluajtshme nr. 5/648*, zona kadastrale nr. 8150, e llojit truall, e ndodhur në Tiranë, e regjistruar në emër të prindërve të kërkuesit Redi Molla (kërkueses Ollga Molla dhe të ndjerit S.M.), si pasuri e përfituar pjesërisht me burime financimi

nga shoqëria "5D", burime financimi që rrjedhin nga produkte të veprës penale; iii. kërkuesen, *shoqërinë "Restur"*, me ortak të vetëm kërkuesin Redi Molla, të fituar për shkak të trashëgimisë nga i ati i ndjerë S. M., së bashku me pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme në pronësi të saj, si dhe *kuotën që ajo zotëron në shoqërinë "Mediterranean Investment Group", të barabartë me 24% të kapitalit të kësaj të fundit,* si pasuri që përbën vlerën ekuivalente të asaj që është përfituar nga veprat penale, vlera e të cilave korrespondon me vlerën e produktit të veprës penale; iv. subjektin e interesuar, shoqërinë "5D", përfshirë kuotat dhe të gjitha pasuritë e paluajtshme e të luajtshme në pronësi të kësaj shoqërie.

4. Me vendimin nr. 388, datë 5.7.2024, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Shkallës së Parë*) ka pranuar kërkesën e Prokurorisë së Posaçme, si të bazuar në ligj dhe në prova, duke vendosur masën e sigurimit pasuror "Sekuestro preventive" për pasuritë e kërkuara, pasi ka çmuar se në rastin konkret plotësoheshin njëkohësisht kushtet ligjore të përcaktuara nga neni 274, pikat 1 dhe 2, të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*) dhe neni 36, pika 1, shkronjat "a", "b", "ç", dhe pikat 2 e 3 të KP-së. Për administrimin e pasurive të sekuestruara është ngarkuar Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara.

5. Në drejtim të përmbushjes së kushteve të përcaktuara në ligj për vendosjen e masës së sekuestros preventive, ajo gjykatë ka analizuar fillimisht për ekzistencën e *dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova*. Në vlerësimin e asaj gjykate, rezulton i mbështetur dyshimi se kërkuesi Redi Molla së bashku me shtetasin M. Q. kanë në zotërim faktik subjektin e interesuar, shoqërinë "5D" dhe, si të tillë, kanë rol thelbësor në administrimin dhe në mënyrën e funksionimit të saj, si dhe kanë kontroll e bartin interesa të drejtpërdrejtë në veprimtarinë ekonomike, duke përfituar drejtpërdrejt vlera financiare nga shpërndarja e fitimeve. Gjatë kohës që kërkuesi Redi Molla ka ushtruar detyrën e drejtorit të ndërmarrjes shtetërore, për pasojë edhe të titullarit të autoritetit kontraktor, shoqëria "5D" ka marrë pjesë dhe është shpallur fituese në 7 procedura prokurimi në sajë të favorizimit dhe të shkeljeve ligjore të kryera nga anëtarët e Komisioneve të Vlerësimit të Ofertave dhe të miratuara nga Redi Molla. Këto procedura prokurimi janë kryer në shkelje të ligjit, duke krijuar pabarazi dhe njëherësh favorizim të kundërligjshëm, po kështu janë zhvilluar edhe në konflikti interesi për shkak të prezencës së interesave pasurorë mbi shoqërinë pjesëmarrëse në procedurën konkurruese. Në këtë pikë, ajo gjykatë ka evidentuar se duhet të jetë pjesë e hetimit në vijim edhe përcaktimi i saktë dhe i plotë i vlerave të mundshme që përbëjnë përfitimet e kërkuara/marra prej Redi Mollës (*shih paragrafin 85, faqja 81, të vendimit të GJKKO-së së Shkallës së Parë*). Ky konkluzion, sipas saj, mbështetet edhe nga mandatpagesa e datës 9.7.2020, për pagesën e dy kësteve për blerjen e pasurive të paluajtshme në emër të prindërve të Redi Mollës. Lidhja e kërkuesit, Redi Mollës, me shoqërinë "5D" përforcohet edhe nga të dhënat që rezultojnë mbi investimin në shoqërinë "Mediterranean Investment Group", në të cilën ka cilësinë e ortakut shoqëria "Restur", zotëruese e 24% të kapitalit, me ortak dhe administrator të atin e kërkuesit Redi Molla, që më pas ka ndërruar jetë. Ky i fundit ka transferuar në rrugë bankare në kapitalin e shoqërisë "Restur" shumën 564.000 euro, që më pas është transferuar nga shoqëria "Restur" tek shoqëria "Mediterranean Investment Group". Pra, sipas gjykatës, shoqëria "Restur" nuk rezulton të ketë zhvilluar ndonjë veprimtari tregtare të vetën, pasi e gjithë vlera e investuar prej saj në shoqërinë "Mediterranean Investment Group" e ka burimin në kreditimet e ish-ortakut. Për më tepër, shoqëria "Mediterranean Investment Group" ka kontraktuar shoqërinë "5D" për ndërtimin e një objekti, ndërsa nga komunikimet ka rezultuar se kërkuesi Redi Molla ka drejtuar punimet (*shih paragrafët 83–87, faqet 72–82, të vendimit të GJKKO-së së Shkallës së Parë*).

6. Lidhur me kushtin e *lidhjes së mjaftueshme me veprën penale*, për pasuritë e paluajtshme në emër të prindërve të kërkuesit Redi Molla, të dyshuara si të fituara pjesërisht me burime financimi

nga shoqëria "5D", që rrjedhin nga produkte të veprës penale, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vlerësuar se plotësohen kriteret ligjore të përcaktuara nga neni 274, pika 1 i KPP-së dhe neni 36, pika 1, shkronja "b", i KP-së në lidhje me pikat 2 dhe 3 të atij neni. Ajo gjykatë ka arritur në këtë përfundim, pasi ka vlerësuar se nga hetimet ka rezultuar: i. dy këste të blerjes së këtyre pasurive janë paguar nga shoqëria "5D" (administruar mandatpagesa për këstin e dytë në vlerën 100.000 euro, me objekt "*pagesë kësti 2 për blerje, pasuritë nr. 5/523 dhe nr. 5/648*"); ii. të dhëna të mjaftueshme për të konkluduar se shoqëria "5D" kontrollohet plotësisht nga kërkuesi Redi Molla, i cili mbart interesa të fshehur në këtë shoqëri, ka dyshime të arsyeshme se këto dy pasuri, jo vetëm janë blerë pjesërisht me vlera monetare nga shoqëria "5D", por edhe se përbëjnë pasuri të fshehura të tij. Në këtë konkluzion gjykata ka arritur pasi: i. të paktën dy këste në vlera të konsiderueshme janë paguar nga shoqëria tek e cila mbart interesa të drejtpërdrejtë pasurorë kërkuesi Redi Molla; ii. ai njihet nga qiramarrësit e pasurive si pronar i tyre; iii. ato janë rikonstruktuar, duke u investuar vlera të konsiderueshme, po nga shoqëria "5D", e lidhur dhe në të cilën mbart interesa kërkuesi Redi Molla. Si përfundim, ajo gjykatë ka konkluduar se për këto dy pasuri ka të dhëna të mjaftueshme se përbëjnë produkte të veprave penale, objekt procedimi. Edhe pse neni 36, pika 2, i KP-së parashikon se nëse produktet e veprës penale janë bashkuar me pasuri të fituara në rrugë të ligjshme, këto të fundit konfiskohen deri në vlerën e produkteve të veprës penale, në rastin konkret, sipas saj, nuk ka pengesë për sekuestrimin e tyre, pasi i përket organit të akuzës që në vijim të hetimeve, të qartësojë nëse e gjithë vlera e tyre vjen si pasojë e transformimit të produktit të tyre të dyshuar të veprës penale, ose vetëm një pjesë e saj, duke u saktësuar kjo vlerë. Lidhur me faktin se këto pasuri të paluajtshme janë në pronësi të prindërve të kërkuesit Redi Molla, sipas asaj gjykate nuk ka pengesë për sekuestrimin e tyre, pasi ka lidhje të mjaftueshme mes tyre dhe veprave penale objekt procedimi (*shih faqet 88 dhe 89, të vendimit të GJKKO-së së Shkallës së Parë*).

7. Po në drejtim të *lidhjes së mjaftueshme me veprën penale,* për shoqërinë "Restur", përfshirë pasuritë e luajtshme, të paluajtshme dhe të drejtat pasurore të saj mbi 24% të kapitalit të shoqërisë "Mediterranean Investment Group", ajo gjykatë ka vlerësuar se ka vend që ky subjekt, me të gjithë pasuritë e tij, të sekuestrohen si vlerë ekuivalente e produktit të veprave penale për të cilat procedohet kërkuesi Redi Molla, për aq sa mund të përcaktohet në këtë fazë të procedimit. Sipas asaj gjykate, në kushtet kur rezulton se shoqëria "Restur" dhe çdo pasuri e saj është në pronësi të kërkuesit Redi Molla, nuk ka pengesë për sekuestrimin e tyre si sende/të drejta që përmbushin vlerën ekuivalente të produktit të veprës penale, në kuptim të nenit 274, pika, 2 të KPP-së dhe nenit 36, pika 1, shkronja "ç", të KP-së, duke lënë si detyrë që në vijim të hetimeve të saktësohet edhe vlera e produktit në raport me vlerën e sendit/asetit të sekuestruar për të përmbushur vlerën ekuivalente të tij (*shih paragrafin 97.6, faqja 88, të vendimit të GJKKO-së së Shkallës së Parë*).

8. Lidhur me ekzistencën e *rrezikut se disponimi i lirë i sendit ose i objektit që lidhet me veprën penale, mund të rëndojë ose të zgjasë pasojat e veprës*, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vlerësuar se, në rastin konkret, rreziku për tjetërsimin, me pasojë rëndimin e mëtejshëm të pasojave të veprës penale, është prezent, real dhe i afërt, për sa kohë tjetërsimi i pasurive të paluajtshme të regjistruara në regjistrat publikë, kalimi i të drejtave mbi kontratat e porosisë për pasuri të paluajtshme apo tjetërsimi i pronësisë së kuotave, ose i aseteve të shoqërive tregtare, është një veprimtari e cila zhvillohet normalisht dhe në mënyrë dinamike, për sa kohë mbi to nuk rezultojnë të regjistruara kufizime mbi tagrin e disponimit të tyre. Për pasuritë e paluajtshme në emër të prindërve të kërkuesit Redi Molla, ajo gjykatë ka arsyetuar se ato pasuri, duke qenë se deri në atë fazë të hetimit rezultojnë të jenë produkte të prejardhura të veprës penale, në kuptim të nenit 36, pika 2, të KP-së, përbëjnë një rrezik real dhe prezent për transferimin e tyre tek të tretët, me qëllim shmangien e

konfiskimit. Ky transferim mund të ndodhë në çdo kohë, duke qenë se janë të regjistruara në emër të të tretëve dhe jo personave nën hetim, duke rënduar kështu pasojat e veprës penale. Në të njëjtën masë gjykata ka vlerësuar edhe rrezikun për tjetërsimin e të drejtave pasurore të kërkuesit Redi Molla mbi kuotat dhe asetet e shoqërisë "Restur" dhe kuotën që kjo e fundit zotëron në shoqërinë "Mediterranean Investment Group". Pavarësisht masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues "Arresti në burg" të vendosur për kërkuesin Redi Molla, sipas gjykatës, tjetërsimi rrezikon të realizohet përmes përfaqësimit.

9. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur ankim kërkuesit, duke pretenduar se vendimi i GJKKO-së së Shkallës së Parë është marrë në shkelje të procesit të rregullt ligjor dhe se mungojnë shkaqet ligjore për vendosjen e kësaj mase, e cila është joproporcionale. Sipas tyre, nuk është paraqitur asnjë lidhje e qartë dhe e paekuivoke midis sendeve/shoqërive të vendosura nën sekuestro dhe veprës penale për të cilën po hetohet, shoqëritë tregtare kanë një historik të gjatë aktiviteti të ligjshëm dhe nga një verifikim i thjeshtë i burimeve të tyre financiare mund të vërtetohet bindshëm ligjshmëria e tyre; kërkuesja Ollga Molla nuk është person nën hetim; masa e sekuestros është joproporcionale për sa kohë që kërkuesit disponojnë burime të ligjshme që justifikon çdo investim ose transaksion të kryer. Duke qenë se kërkuesit nuk kanë pasur akses në fashikullin gjyqësor, kanë rezervuar të drejtën për të paraqitur argumente shtesë në seancën gjyqësore.

10. Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Apelit*) ka marrë në shqyrtim çështjen në dhomën e këshillimit dhe me vendimin nr. 162 (87-2024-2019), datë 31.7.2024, ka miratuar vendimin e GJKKO-së së Shkallës së Parë, pasi ka vlerësuar se në rastin konkret ekzistojnë kushtet ligjore për caktimin e masës së sigurimit pasuror "Sekuestro preventive", të parashikuar nga neni 274 i KPP-së, por më një arsyetim të ndryshëm ligjor, pasi nuk është pajtuar me kualifikimin juridik të fakteve penale. Sipas saj, ekziston dyshimi i arsyeshëm se personat e proceduar kanë konsumuar elementet e veprave penale për të cilat akuzohen në kuadër të grupit të strukturuar kriminal si formë e posaçme bashkëpunimi dhe se lënia pa masë sigurimi pasurore e çdo gjurme të pasurisë kriminale të subjektit të interesuar, shoqërisë "5D", përbën një mundësi praktike dhe reale të bashkëpunëtorëve për të fshehur origjinën e tyre, duke lehtësuar sakaq vijimësinë e pashqetësuar të grupit të strukturuar kriminal dhe kryerjen e veprave të tjera kriminale. Në lidhje me formën e shqyrtimit të kërkesës së Prokurorisë së Posaçme, GJKKO-ja e Apelit ka evidentuar se ajo duhet shqyrtuar në dhomën e këshillimit me praninë e palëve, ndërsa ka vërejtur se në rastin konkret është shqyrtuar në seancë gjyqësore dhe vetëm me praninë e prokurorit, megjithatë ka çmuar se kjo nuk ka prodhuar pasoja ligjore që ta bënin vendimin e GJKKO-së së Shkallës së Parë të cenueshëm.

11. Shkaqet e ankimit të kërkuesve ajo gjykatë i ka gjetur haptazi të pabazuara, pasi ka vlerësuar se nga të dhënat e deritanishme të procedimit penal provohet se pasuritë e sekuestruara e kanë origjinën nga fondet e shoqërisë "5D". Për rrjedhojë, sipas saj, nuk ka asnjë dobi vërtetimi i aftësisë paguese apo pasurive të kërkuesve Redi dhe Ollga Molla për të justifikuar vlerën e pasurive të sekuestruara, pasi provohet se secila prej tyre e ka origjinën nga produktet e veprës penale krijuara të ndër vite nga shoqëria "5D". Për rrjedhojë, GJKKO-ja e Apelit ka çmuar se masa e kërkuar nga Prokuroria e Posaçme pajtohet plotësisht me parimin e proporcionalitetit dhe se, për më tepër, konstatohet që ka një përputhshmëri dhe gjurmueshmëri ideale ndërmjet produkteve të veprës penale dhe tjetërsimit të saj tek të tretët, ose përvetësimit dhe investimit të saj nga bashkëpunëtorët e proceduar apo të paproceduar deri më tani nga kjo prokurori.

12. GJKKO-ja e Apelit ka konstatuar edhe disa çështje kryesisht, duke i lënë si detyra për vijimin e hetimeve paraprake. Ndër të tjera, ajo gjykatë ka shprehur mospajtim me Prokurorinë e Posaçme lidhur me kufirin e vendosur për vlerën e pasurive, me qëllim që ajo të mos e kalojë

vlerën e ekspertuar të fitimeve kriminale të realizuara nga shoqëria "5D". Sipas saj, mënyra e zbatimit të nenit 274 të KPP-së është e pabazuar në nenin 36 të KP-së, sipas së cilës pasuritë e kërkuara për sekuestrim nuk duhet të tejkalojnë vlerën ekuivalente të fitimeve kriminale që rrjedhin nga 13 procedurat e realizuara të prokurimit.

13. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur rekurs, ndër të tjerë, kërkuesit, duke pretenduar zbatimin e gabuar të ligjit procedural penal me pasojë pavlefshmërinë e vendimeve gjyqësore të lidhura kryesisht me vendimmarrjen në mungesë të kontradiktoritetit, paanshmërinë e gjyqtarit të gjykatës së apelit dhe daljen jashtë shkaqeve të ankimit, me pasojë rëndimin e pozitës së kërkuesve, si dhe mungesën e kushteve ligjore për caktimin e masës. Kërkuesit kanë pretenduar se atyre nuk u është dhënë akses gjatë gjykimit në shkallën e parë dhe se gjykimi në apel është zhvilluar në dhomën e këshillimit, pa praninë e palëve, ku kërkuesve u është lënë një afat kohor shumë i shkurtër për të paraqitur ankim, që e ka bërë objektivisht të pamundur paraqitjen e një akti ekspertimi kontabël. Sipas tyre, në fashikullin gjyqësor mungon një analizë e mirëfilltë financiare për burimet e ligjshme të pasurive, arsye për të cilën kanë paraqitur përpara Gjykatës së Lartë një analizë financiare për të ardhurat e prindërve të kërkuesit Redi Molla (kërkueses Ollga Molla dhe të ndjerit S. M.), të hartuar nga një audituese ligjore e pavarur (akti i ekspertimit i datës 11.9.2024).

14. Me vendimin nr. 00-2024-2041 (307), datë 12.12.2024, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit. Për pretendimin e kërkuesve lidhur me mosnjoftimin për zhvillimin e gjykimit në gjykatën e shkallës së parë dhe më tej, për shqyrtimin e çështjes në dhomën e këshillimit në gjykatën e apelit, pa praninë e palëve, ajo gjykatë, në mungesë të një parashikimi konkret në dispozitat që normojnë sekuestron preventive, ka referuar në dispozitat për masat e sigurimit personal, duke vlerësuar se edhe masat e sigurimit pasuror, si rregull, shqyrtohen në dhomën e këshillimit, me kushtin që të zbatohen rregullat për këtë rit gjykimi dhe të njoftohen paraprakisht palët sipas nenit 426 të KPP-së, në mënyrë që të kenë mundësi të paraqesin parashtrime me shkrim. Pavarësisht këtij konkluzioni, Gjykata e Lartë ka vlerësuar se gjykata e apelit nuk ka asnjë pengesë që të procedojë me kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore sa herë që lind nevoja e dëgjimit të palëve ose verifikimit të pjesës faktike të çështjes. Në çështjen konkrete, ajo gjykatë ka vlerësuar se nuk konstatohet pavlefshmëria e vendimeve gjyqësore, pasi GJKKO-ja e Apelit ka shqyrtuar ankimin e kërkuesve, duke i njoftuar paraprakisht për datën dhe orën e shqyrtimit të çështjes në dhomën e këshillimit në gjykatën e apelit, si dhe duke i dhënë mundësinë për të paraqitur edhe parashtrime me shkrim për shkaqet e ngritura në gjykatën e apelit. Për këtë arsye, por edhe për shkak se dispozitat që normojnë sekuestron preventive nuk parashikojnë domosdoshmërinë e thirrjes së palëve, Gjykata e Lartë nuk ka konstatuar asnjë pavlefshmëri me pasojë cenimin e vendimmarrjes objekt rekursi (*shih paragrafët 27–31, të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Për sa i përket mënyrës së procedimit të GJKKO-së Shkallës së Parë, ajo gjykatë ka mbështetur arsyetimin e GJKKO-së së Apelit (*shih paragrafin 33, të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

15. Pretendimin për mungesën e kushteve për caktimin e masës së sekuestros preventive, Gjykata e Lartë e ka gjetur të pabazuar, duke arsyetuar, *së pari*, se, në mënyrën sesi janë parashtruar pretendimet, vlerësohen të karakterit faktual, pra jashtë juridiksionit të Gjykatës së Lartë dhe, *së dyti*, kushtet dhe kriteret për caktimin e masës janë analizuar në mënyrë të detajuar e mbi bazën e të dhënave të hetimeve paraprake nga gjykatat më të ulëta. Ajo gjykatë ka vlerësuar se gjykatat e faktit kanë arsyetuar për kushtet dhe kriteret për caktimin e masës së sekuestros preventive duke dhënë vendime në përputhje me nenin 274 të KPP-së, të cilat nuk janë të cenueshme. Lidhur me pretendimet se sekuestroja është vendosur mbi pasuri të një personi që nuk është nën hetim, Gjykata e Lartë ka arsyetuar se objekt i sekuestrimit mund të jetë edhe një pasuri

e një personi që nuk ka lidhje me krimin, për sa kohë që kjo pasuri është e lidhur në mënyrë indirekte me krimin dhe mund të përbëjë rrezik për rëndimin ose zgjatjen e pasojave të veprës penale, ose lehtësimin e kryerjes së fakteve penale të mëtejshme (*shih paragrafët 34–39, të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

16. Për sa u përket pretendimeve për arsyetimin e vendimit të GJKKO-së së Apelit, Gjykata e Lartë ka vlerësuar se ndonëse në dukje gjykata e apelit ka arsyetuar ndryshe nga gjykata e shkallës së parë (kryesisht në cilësimin juridik të faktit penal), në thelb nuk ka asnjë kontradiktë me të dhe me kërkesën e Prokurorisë së Posaçme për ekzistencën e kushteve dhe të nevojave në rastin konkret për caktimin e masës së sekuestros preventive, duke i vlerësuar vendimet e gjykatave të posaçme plotësuese të njëra-tjetrës (*shih paragrafin 40 të vendimit të Gjykatës së Lartë)*. Ndërsa lidhur me pretendimin se GJKKO-ja e Apelit ka rënduar pozitën e kërkuesve, duke shtuar si nevojë sigurimi rrethanën e kryerjes së veprës në bashkëpunim të posaçëm, të papretenduar nga Prokuroria e Posaçme dhe të paevidentuar nga gjykata e shkallës së parë, Gjykata e Lartë, ndonëse ka vlerësuar se formalisht qëndron, ka çmuar se ai argument nuk përbën shkak për të cenuar atë vendimmarrje për shkak të mosardhjes së pasojave ligjore (*shih paragrafin 41, të vendimit të Gjykatës së Lartë)*. Pretendimin se masa është shpërpjesëtimore, Gjykata e Lartë e ka çmuar të pabazuar, me arsyetimin se shkaqet e paraqitura në rekurs nuk evidentojnë që masat e caktuara ndaj pasurive të jenë dukshëm arbitrare ose joproporcionale (*shih paragrafin 42, të vendimit të Gjykatës së Lartë)*. Së fundmi, ajo gjykatë e ka gjetur të pabazuar edhe pretendimin për paanshmëri të gjyqtarit të apelit, për shkak të mungesës së shkaqeve të arsyeshme të mbështetura në prova, pasi ka çmuar se, në thelb, arsyet mbështeten tek ushtrimi i vendimmarrjes së gjyqtarit konform tagrave që i njeh ligji (*shih paragrafin 43, të vendimit të Gjykatës së Lartë)*.

17. Në datën 27.6.2025, kërkuesit i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij. Në datën 24.9.2025, Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

18. Në datën 20.4.2026, një anëtar i Gjykatës ka paraqitur kërkesë për heqjen dorë nga shqyrtimi i çështjes, pasi paanshmëria mund të vihet në dyshim për shkaqe të tjera. Po në të njëjtën datë, Mbledhja e Gjyqtarëve ka vendosur pranimin e kërkesës, duke vlerësuar se gjyqtari gjendej përpara rastit të parashikuar në nenin 36, pika 1, shkronja "ç", të Ligjit Organik të Gjykatës.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

19. ***Kërkuesit,*** në mënyrë të përmbledhur, kanë pretenduar se vendimet gjyqësore të kundërshtuara u kanë cenuar:

19.1 *Të drejtën për proces të rregullt ligjor*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektet e mëposhtme:

19.1.1 *E drejta e aksesit e* lidhur me të *drejtën për t'u dëgjuar e për t'u mbrojtur dhe parimin e barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit*, pasi gjykatat e posaçme e kanë zhvilluar gjykimin vetëm në prani të prokurorit dhe, për rrjedhojë, janë mbështetur vetëm në provat e paraqitura nga ai. Veçanërisht, kërkuesit kanë përgatitur një akt ekspertimi kontabël, që është një provë thelbësore e këtij procesi, mirëpo nuk kishin arritur ta paraqisnin atë apo kundërshtimet e tyre për shkak se nuk ishin të pranishëm, si dhe për shkak të afateve të shkurtra në dispozicion për kundërshtimin e tyre. Dispozitat procedurale që rregullojnë sekuestron preventive nuk parashikojnë ndonjë mënyrë të veçantë gjykimi, siç parashikohet në rastin e caktimit të masave të sigurimit personal, në të cilin ligji parashikon shprehimisht se vendimi merret në dhomën e këshillimit. Ndërsa në rastin konkret,

ligjvënësi ka konfirmuar vullnetin e tij për gjykimin e këtyre kërkesave në mënyrën tradicionale të zhvillimit të seancës gjyqësore. Në shkelje të normave procedurale, GJKKO-ja e Shkallës së Parë e ka zhvilluar gjykimin në dhomën e këshillimit, pa njoftuar, pa thirrur dhe pa dëgjuar kërkuesit, edhe pse në përfundim të gjykimit janë cenuar të drejtat e tyre të pronësisë. GJKKO-ja e Apelit jo vetëm që ka legjitimuar shkeljen procedurale të lejuar në gjykatën e shkallës së parë, por e ka thelluar atë nëpërmjet mohimit edhe nga ana e saj të parimit të kontradiktoritetit, duke zhvilluar një gjykim tërësisht formal. Edhe Gjykata e Lartë, megjithëse kishte mundësi të riparonte shkeljet procedurale të gjykatave të posaçme, vendosi të linte në fuqi vendimin e gjykatës së apelit, duke u mohuar përfundimisht kërkuesve mundësinë të paraqisnin prova në mbrojtje të tyre, përfshirë aktin e ekspertimit për pasuritë e prindërve të kërkuesit Redi Molla.

19.1.2 *Parimi i prezumimit të pafajësisë dhe paanësisë*, pasi GJKKO-ja e Apelit ka shtuar si elemente mbështetëse për nevojat e sigurimit, kryerjen e veprës penale nga të hetuarit nën formën e një grupi të strukturuar kriminal, duke rikualifikuar faktin penal sipas neneve 143, 287, 334 të KP-së, ndërkohë që prokurori në kërkesën për caktimin e masës është mjaftuar me bashkëpunimin e thjeshtë. Ajo gjykatë ka tejkaluar rolin e saj si gjykatë e hetimeve paraprake, duke e konfonduar me rolin e gjykatës së seancës paraprake. Po e njëjta gjykatë ka mbajtur dhe herë të tjera këtë qëndrim, konkretisht në caktimin e masës së sigurimit personal për kërkuesin Redi Molla, por në atë rast kjo parregullsi është korrigjuar nga Gjykata e Lartë, e cila e ka prishur vendimin e gjykatës së apelit dhe e ka dërguar çështjen për rishqyrtim. Përsëritja e të njëjtit qëndrim është indikacion i qartë se GJKKO-ja e Apelit e ka shqyrtuar çështjen me bindjen se kërkuesi Redi Molla është fajtor dhe se veprat e kryera nga ai janë më të rënda se ato të pretenduara nga Prokuroria e Posaçme, duke rënduar pozitën e tij. Ajo gjykatë e ka tejkaluar pragun e shfaqjes së një mendimi ose sugjerimi mbi formën e bashkëpunimit apo kualifikimin e faktit penal, pasi, siç ajo arsyeton, udhëhiqet nga një bindje e plotë se ai është fajtor dhe tenton ta orientojë Prokurorinë e Posaçme që të veprojë sipas bindjes së saj.

19.1.3 *Standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor,* pasi në çështjen konkrete gjykatat nuk kanë paraqitur një lidhje të qartë midis pasurive dhe aseteve të vendosura nën sekuestro dhe veprës penale për të cilën po hetohet kërkuesi Redi Molla. Ato nuk kanë specifikuar se në cilën prej kategorive të nenit 274 të KPP-së dhe nenit 36 të KP-së përfshihen sendet e sekuestruara. Duke pasur parasysh faktin se disa nga pasuritë e sekuestruara janë në pronësi të personave të tretë, që nuk kanë lidhje me procedimin penal (kërkuesja Ollga Molla), organi i akuzës dhe gjykatat duhet të kishin arsyetuar me argumente konkrete arsyet e vendosjes së sekuestros për këto pasuri. Shoqëritë tregtare dhe i ndjeri S. M. kanë një historik të gjatë aktiviteti tregtar dhe do të mjaftonte një verifikim i thjeshte i burimeve financiare për të vërtetuar ligjshmërinë e tyre. Ky është tregues që gjykatat kanë kryer një gjykim formal, pa një arsyetim ligjor mbi baza shkencore kontabël. Si organi i akuzës, ashtu edhe gjykatat kanë arsyetuar në mënyrë të përgjithshme mbi kushtet dhe kriteret për caktimin e masave të sigurimit pasuror. Ato nuk kanë arsyetuar se përse një kufizim i tillë i tagrave të pronësisë ishte mjeti i vetëm për të siguruar qëllimin e synuar dhe nuk kishte asnjë mjet tjetër, në kuptim të parimit të proprorcionalitetit që të arrinte një rezultat më pak të dëmshëm në të drejtën kushtetuese. Çdo masë që mund të ndërhyjë në të drejtat e individëve nën hetim dhe, sidomos atyre që nuk janë nën hetim, duhet të arsyetohet në drejtim të rezultateve parandaluese që synohen të arrihen. Sekuestroja duhet të urdhërohet si mjet i fundit, në mungesë të alternativave që janë në të njëjtën masë efektive, ndërkohë që kufizimi duhet të argumentohet në lidhje me shkaqet që e justifikojnë atë.

19.1.4 *Parimi i sigurisë juridike*, pasi në procesin që lidhej me vazhdimin e masës së sigurimit personal të caktuar ndaj kërkuesit Redi Molla, Gjykata e Lartë, pasi ka vlerësuar se gjyqtari i

hetimit paraprak në gjykatën e apelit ka marrë kompetencat e gjyqtarit të seancës paraprake, duke ushtruar kontroll mbi veprimtarinë e prokurorit, nëpërmjet kualifikimit të veprave penale, ka vendosur të prishë vendimin e gjykatës së apelit dhe e ka dërguar çështjen për rishqyrtim në po atë gjykatë. Përballë po së njëjtës sjellje të GJKKO-së së Apelit, mbi po të njëjtat fakte, Gjykata e Lartë ka mbajtur qëndrim katërcipërisht të kundërt kësaj radhe, duke krijuar rrjedhimisht konfuzion që cenon rëndë parimin e sigurisë juridike.

19.2 *Të drejtën për pronë private*, të garantuar nga neni 41 i Kushtetutës, pasi:

19.2.1 Ndërhyrja *nuk është e bazuar në ligj*, sepse legjislacioni penal material dhe procedural lejon kufizimet e kësaj të drejte vetëm ndaj personave që dyshohet se kanë kryer veprën penale, ndërsa në rastin konkret masa është shtrirë automatikisht dhe vetëm për shkak të lidhjes familjare, edhe te pjesët takuese të kërkueses Ollga Molla, e cila nuk është person nën hetim, në mungesë të plotë të të dhënave ose të një analize nga gjykatat. Ajo ka qenë bashkëpronare në pasuritë objekt sekuestroje përpara se t'i trashëgonte i biri. Nuk rezulton që gjykatat të kenë arsyetuar se përse përfshihet dhe pjesa takuese e saj në sekuestro dhe cilat janë faktet që pasjellin lindjen e dyshimit se pjesa e saj takuese mund të jetë krijuar nga të ardhurat nga ndonjë vepër penale.

19.2.2 *Ndërhyrja nuk plotëson kriterin e ligjshmërisë*, pasi ajo nuk plotëson kriteret e nenit 274 të KPP-së, sipas të cilit duhet të provohet lidhja e sendit për të cilin kërkohet të vendoset masa e sigurimit pasuror me veprën penale në ngarkim të kërkuesit. Nga akti i ekspertimit të kryer nga organi i akuzës, duket qartë se fokusi i tij ka qenë shoqëria "5D" dhe jo verifikimi i të ardhurave të kërkuesit Redi Molla ose familjarëve të tij, për të cilat nuk ka asnjë indicie ose provë për të arritur në konkluzionin që pasuritë e paluajtshme janë produkte të veprës penale.

19.2.2.1 Lidhur me *pasurinë e paluajtshme nr. 5/523*, të trashëguar nga S. M. tek kërkuesi Redi Molla, nuk rezulton që të jetë hetuar ose arsyetuar për lidhjen e saj me veprat penale për të cilat akuzohet ky kërkues. Pagesa e pretenduar prej 100.000 eurosh e kryer nga shoqëria "5D" është bërë vetëm për pasurinë nr. 5/648, ndaj është e paqartë lidhja dhe përfshirja në sekuestro edhe e pasurisë nr. 5/523. Nuk ka asnjë arsyetim për sekuestrimin e pjesës takuese të kërkueses Ollga Molla, e cila nuk është person nën hetim.

19.2.2.2 Lidhur me kërkuesen, shoqërinë "*Restur*", fituar nga trashëgimia, nuk është hetuar dhe as arsyetuar se ku është dyshimi që kjo pasuri mund të jetë krijuar nga produktet e veprës penale. Në këtë kuptim, është e paqartë sesi kuota që kërkuesi Redi Molla ka në këtë shoqëri, me vlerë nominale 100 lekë, mund të dyshohet si produkt i veprës penale. Shoqëria ka histori të gjatë aktiviteti tregtar, që nuk është verifikuar.

19.2.2.3 Lidhur me kërkuesen "*Mediterranean Investment Group*", rezulton se ajo është krijuar më 1.9.2020, me kapital 100 lekë, aq sa e ka edhe sot. Nga krijimi i saj e deri në vitin 2023, nga ana e të ndjerit S. M. është kaluar në shoqëri vlera 564.000 euro në kuadër të zhvillimit të projektit, e cila nuk ishte verifikuar për burimin e saj, që të përligjte vënien e sekuestros për të.

19.2.3 *Nuk plotësohet kriteri i proporcionalitetit*, pasi kufizimi i së drejtës së pronësisë së kërkuesve është bërë përmes një mjeti të papërshtatshëm, siç është sekuestroja preventive, në kushtet kur qëllimi i kërkuar nga neni 274 i KPP-së mund të arrihet me mënyra të tjera, si ndalimi i tjetërsimit të pasurive dhe i kuotave të sekuestruara duke bërë shënimet përkatëse në regjistrin e pasurive të paluajtshme dhe në regjistrin tregtar, për më tepër, në kushtet kur vlera prej 564.000 eurosh do të shërbente për të paguar kontraktorët dhe nënkontraktorët. Gjykatat nuk kanë arsyetuar pse prevalon interesi publik mbi të drejtat e pronësisë dhe as pse vendosja e sekuestros është masa me e përshtatshme. Po kështu, vendosja e kërkuesit Redi Molla nën masën e sigurimit personal, passjell edhe kufizime të të drejtave të tij të pronësisë, pasi ai është i kufizuar nga disponimi i tyre, si pasojë e kufizimit të lirisë.

20. ***Subjekti i interesuar, shoqëria "5D",*** në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se vendimet e gjykatave për vendosjen dhe miratimin e sekuestros preventive *en block,* mbi të gjitha pasuritë e shoqërisë "5D", nuk kanë respektuar kriterin e proporcionalitetit, në mënyrë që kufizimi i së drejtës së pronësisë të bëhej me mjete sa më të përshtatshme, të mjaftueshme për të realizuar qëllimin e ligjshëm që duhet të ndjekë juridiksioni. Ato gjykata qëllimisht e kanë përzier veprimtarinë sipërmarrëse të financuar me fonde publike të shoqërisë "5D" me veprimtarinë e saj private, e cila nuk ka asnjë lidhje me tenderët e pretenduar të fituar në mënyrë të padrejtë nga kjo shoqëri. Shoqëria "5D" ka marrë disa kredi me vlera të konsiderueshme, të cilat janë fonde tërësisht të ligjshme, ndaj sekuestroja është shpërpjesëtimore në raport me qëllimin e ligjshëm që pretendon të realizojë. Për më tepër, kjo masë shpërpjesëtimore po rrezikon të krijojë pasoja duke dëmtuar edhe interesat e individëve privatë, klientë të shoqërisë, të cilët kanë parapraguar në mënyrë të ligjshme nëpërmjet sistemit bankar kështet e pagesave për blerjen e apartamenteve që kanë porositur në pallatin që kjo shoqëri po ndërton në rrugën "Siri Kodra", Tiranë.

21. ***Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme,*** në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar si vijon:

21.1 Pretendimi për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor është i pabazuar, pasi:

21.1.1 Kërkuesve u është garantuar e *drejta e aksesit në gjykatë* e lidhur me të *drejtën për t'u mbrojtur dhe parimin e barazisë së armëve e të kontradiktoritetit*. Ashtu siç ka vlerësuar edhe Gjykata e Lartë, ndryshe nga rregullat procedurale të shqyrtimit të masave të sigurimit personal, në rastin e masave të sigurimit pasuror nuk ka rregullime të detajuara mbi ritin e gjykimit të tyre, si për gjykimin fillestar, ashtu edhe për atë rishikues në gjykatën e apelit. Kjo do të thotë se gjykimi në shkallë të parë i kërkesës së prokurorisë bëhet në dhomën e këshillimit, pa praninë e palëve, me kusht që palët të njoftohen dhe të kenë mundësi për të paraqitur parashtrime 5 ditë përpara seancës, duke iu garantuar mundësia që të paraqesin argumentet e tyre dhe në këtë mënyrë të "dëgjohen". Në rastin konkret, GJKKO-ja e Apelit i ka njoftuar paraprakisht palët për shqyrtimin e ankimit, duke iu dhënë mundësinë për paraqitjen e parashtrimeve me shkrim lidhur me shkaqet e ngritura në gjykatën e apelit. Për sa i takon gjykatës së shkallës së parë, me të vërtetë ka pasur një shkelje lidhur me ritin e gjykimit, porse, ashtu siç ka vlerësuar edhe Gjykata e Lartë, ajo nuk është e tillë sa të bëjë nul vendimin e marrë, pasi në thelb nuk ka sjellë asnjë pasojë ligjore. Kërkuesit kanë pasur mundësi të njihen me vendimin e gjykatës së shkallës së parë, të ushtrojnë mjetet e ankimit dhe të paraqesin argumentet e tyre përpara gjykatës më të lartë. Shqyrtimi i kërkesës së Prokurorisë së Posaçme është në përputhje me ligjin, standardet kushtetuese dhe konventore, si dhe ka ruajtur balancën ndërmjet interesit publik dhe të drejtave individuale.

21.1.2 Kërkuesve nuk u është cenuar *parimi i prezumimit të pafajësisë* dhe ai i *paanshmërisë* nga GJKKO-ja e Apelit, për sa kohë që arsyetimi tej qëndrimit të Prokurorisë së Posaçme, tej arsyetimit të vendimit të shkallës së parë dhe tej shkaqeve të ankimit, nuk shoqërohen me asnjë pasojë ligjore, duke qenë se arsyetimi për këtë pikë nuk ka forcë detyruese, por vetëm orientuese ndaj Prokurorisë së Posaçme në këtë fazë të procedimit penal (hetime paraprake), ndaj nuk përbën shkelje të tillë sa ta bëjë nul vendimin e marrë. Pavarësisht se Prokuroria e Posaçme nuk ndan të njëjtin qëndrim me gjykatat e posaçme në drejtim të kualifikimit ligjor të faktit penal ose llojit të bashkëpunimit, të dyja gjykatat kanë të njëjtin qëndrim dhe kanë argumentuar mjaftueshëm ekzistencën e kushteve të parashikuara në nenin 274 të KPP-së. Gjykatat kanë përmbushur detyrimin e tyre për respektimin e parimit të prezumimit të pafajësisë në vlerësimin e provave dhe ato nuk kanë zhvendosur barrën e provës te kërkuesit dhe as nuk kanë nxjerrë prezumime fakti të paarsyeshme. Ato kanë përcaktuar dyshimin e arsyeshëm të të hetuarve, duke argumentuar praninë e një sërë indiciesh që lidhin sendin/pasurinë me fakte që kualifikohen si vepra penale.

21.1.3 Shkaqet e parashtruara nga kërkuesit për të argumentuar cenimin e *parimit të sigurisë juridike* lidhen me vendimin nr. 18, datë 3.5.2024, të GJKKO-së së Apelit (për vazhdimin e masës së sigurimit "Arresti në burg" ndaj kërkuesit Redi Molla), i cili nuk është objekt i kërkesës. Gjithashtu, ai vendim është prishur nga Gjykata e Lartë me arsyetimin e cenimit të parimit të gjykatës së caktuar me ligj nga gjyqtari i hetimit paraprak, ndaj edhe ai vendim nuk prodhon më efekte.

21.1.4 Gjykatat *kanë arsyetuar mjaftueshëm* lidhur me nevojën, përshtatshmërinë dhe proporcionalitetin e masës, si dhe kanë mbajtur në konsideratë se ajo masë përmbush qëllimin për të cilin është caktuar. Gjykatat e posaçme, në thelb, kanë kontradiktë në vendimmarrjet e tyre lidhur me ekzistencën e kushteve dhe të nevojave për caktimin e masës në rastin konkret. Ato kanë analizuar në mënyrë cilësore indiciet dhe provat që mbështesin kërkesën e Prokurorisë së Posaçme. Edhe Gjykata e Lartë ka arsyetuar se objekt sekuestrimi mund të jetë çdo e mirë (send), për këdo që i përket, përfshirë edhe një person që nuk ka lidhje me veprën penale, për sa kohë që ajo pasuri është e lidhur me atë vepër penale.

21.2 I pabazuar është edhe pretendimi për cenimin e së *drejtës së pronës* në drejtim të *proporcionalitetit të ndërhyrjes,* pasi masat e caktuara ndaj pasurive në fjalë nuk janë dukshëm arbitrare ose joproporcionale. Gjykatat kanë arsyetuar, në rastin konkret, rreth domosdoshmërisë, proporcionalitetit dhe përshtatshmërisë. Gjykata e Lartë ka arsyetuar se kufizimet/ndërhyrjet në të drejtat dhe liritë kushtetuese lidhur me pasurinë, si pasojë e caktimit të masës së sigurimit pasuror, janë rrjedhojë e baraspeshimit të drejtë midis interesit publik dhe interesave personalë të personave të prekur nga kjo ndërhyrje.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesve

22. Fillimisht Gjykata vëren se objekti i ankimit kushtetues individual janë vendimet gjyqësore që kanë pranuar kërkesën e Prokurorisë së Posaçme për vendosjen e masës së sekuestros preventive për disa pasuri në emër të kërkuesve dhe të subjektit të interesuar, shoqërisë "5D". Kërkuesit i kanë kundërshtuar këto vendime, duke paraqitur ankim kushtetues individual në datën 27.6.2025. Në datën 24.9.2025, Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve dhe thirrjen e shoqërisë "5D", si subjekt të interesuar, e cila, në vijim, është njoftuar rregullisht për të paraqitur vetëm prapësimet që lidhen me objektin e kërkesës. Me parashtrimet e datës 30.10.2025, subjekti i interesuar, shoqëria "5D", ka kundërshtuar procesin gjyqësor, objekt të ankimit kushtetues individual, duke ngritur pretendime për cenimin e të drejtave të tij kushtetuese për shkak të masës së sekuestros preventive për pasurinë e regjistruar në pronësi të këtij subjekti. Gjykata, duke pasur parasysh se subjektet e interesuara thirren në gjykim në mënyrë që të kontribuojnë në shqyrtimin e çështjes që po gjykohet, në rastin konkret, për ankimin kushtetues individual të kërkuesve, si dhe në situatën kur ky subjekt i interesuar edhe pse ka qenë palë në procesin gjyqësor objekt të këtij gjykimi, nuk i është drejtuar në formë dhe në përmbajtje Gjykatës për kundërshtimin e tij me ankim kushtetues individual për sa masa e sekuestros ka prekur interesat e tij, vlerëson se kërkimet ngushtësisht personale të paraqitura nga ky subjekt nuk mund të merren në konsideratë. Kjo do të thotë se vendimet e kundërshtuara për caktimin e masës së sigurimit pasuror "Sekuestro preventive" për pasuritë/kuotat e shoqërisë "5D" nuk janë pjesë e shqyrtimit të këtij gjykimi kushtetues, pasi për to kërkuesit nuk kanë paraqitur ndonjë pretendim.

23. Çështja e legjitimimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f", dhe 134, pikat 1, shkronja "i", dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

24. Për verifikimin e këtyre kritereve në çështjen konkrete, Gjykata evidenton fillimisht se kërkuesit, persona fizikë dhe juridikë, i janë drejtuar Gjykatës për kundërshtimin e vendimeve gjyqësore të dhëna ndaj tyre. Në këtë pikë vlen të mbahet në konsideratë se neni 16, pika 2, i Kushtetutës garanton të drejtat, liritë themelore dhe detyrimet e parashikuara në të edhe për personat juridikë, për aq sa ato përputhen me qëllimet e përgjithshme të këtyre personave dhe me thelbin e këtyre të drejtave, lirive dhe detyrimeve. Prandaj, Gjykata vlerëson se kërkuesit, si bartës të të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara nga Kushtetuta, legjitimohen *ratione personae,* në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja "f", dhe 134, pikat 1, shkronja "i", dhe 2, të Kushtetutës, pasi jo vetëm që kanë qenë palë në procesin gjyqësor të kundërshtuar, por edhe kanë provuar se pasojat e pretenduara në të drejtat e tyre kushtetuese kanë ardhur nga vendimet gjyqësore objekt kërkese që kanë caktuar masën e sigurimit pasuror "Sekuestro preventive" për pasuritë e tyre.

25. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Gjykata, edhe pse nuk e ka vënë në dyshim karakterin e ndërmjetëm të vendimeve për caktimin e masës së sekuestros së pasurisë, i ka përfshirë në juridiksionin e saj këto lloj vendimesh, të cilat, pavarësisht se kanë karakter të përkohshëm dhe nuk vendosin për themelin e çështjes, janë të afta të ndërhyjnë në të drejtën kushtetuese të pronës private, ndërhyrje që vazhdon deri në dhënien e një vendimi të mundshëm për konfiskimin e pasurisë. Për sa kohë që pretendimet në ankimin kushtetues individual kanë të bëjnë me cenimin e të drejtave substanciale kushtetuese, këto vendime konsiderohen me natyrë përfundimtare për qëllime të kontrollit kushtetues (*shih vendimet nr. 20, datë 11.4.2025;, nr. 29, datë 16.4.2024; nr. 18, datë 19.3.2024, të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Po kështu, kriteri për shterimin e mjeteve nënkupton jo vetëm që individi t'u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t'i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimet nr. 40, datë 14.5.2024; nr. 38, datë 12.7.2023; nr. 33, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë drejtim, Gjykata vëren se kërkuesit i kanë ngritur në formë dhe në substancë përpara gjykatave të zakonshme pretendimet e parashtruara në ankimin kushtetues individual. Për rrjedhojë, edhe ky kriter legjitimimi për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues konsiderohet i përmbushur.

27. Kërkuesit legjitimohen edhe *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja "b", të Ligjit Organik të Gjykatës, pasi vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Gjykatës së Lartë, mban datën 12.12.2024, i cili është publikuar në faqen zyrtare të saj në datën 3.3.2025, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 27.6.2025, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

28. Në lidhje me legjitimimin *ratione materiae*, Gjykata vëren se kërkuesit kanë kundërshtuar vendimet gjyqësore që kanë pranuar kërkesën e Prokurorisë së Posaçme për vendosjen e masës së sekuestros preventive për disa pasuri, duke pretenduar se u janë cenuar e *drejta për proces të rregullt ligjor,* e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës (në aspektet e së drejtës së aksesit të lidhur

me të drejtën për t'u dëgjuar e për t'u mbrojtur dhe parimin e barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit, parimin e prezumimit të pafajësisë dhe të paanshmërisë, standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe parimin e sigurisë juridike), si dhe *e drejta për pronë private*, e garantuar nga neni 41 i Kushtetutës.

29. Pretendimin për cenimin e procesit të rregullt ligjor në aspektin e *së drejtës së aksesit* të lidhur me *të drejtën për t'u dëgjuar e për t'u mbrojtur dhe parimin e barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit,* kërkuesit e kanë lidhur me gjykimin në shkallën e parë vetëm me praninë e prokurorit, si dhe me formën e gjykimit në dhomën e këshillimit dhe moslejimin e debatit për provat as në gjykatën e apelit, shkelje që, sipas tyre, nuk janë marrë parasysh nga Gjykata e Lartë. Sipas kërkuesve, në rastin e masave të sigurimit me karakter pasuror, për sa kohë që ligjvënësi nuk ka parashikuar në mënyrë të shprehur gjykimin në dhomën e këshillimit për këto kërkesa, duhet të zbatohen rregullat e përgjithshme të gjykimit. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, ka prapësuar se për sa kohë që për masat e sigurimit pasuror nuk ka rregullime të detajuara mbi ritin e gjykimit të tyre, gjykimi në shkallën e parë i kërkesës së Prokurorisë së Posaçme bëhet në dhomën e këshillimit, pa praninë e palëve, me kusht që palët të njoftohen dhe të kenë mundësi për të paraqitur parashtrime 5 ditë përpara seancës. Sipas saj, në rastin konkret, GJKKO-ja e Apelit u ka dhënë mundësinë kërkuesve për paraqitjen e parashtrimeve me shkrim për shkaqet e ngritura në apel. Për sa i takon gjykatës së shkallës së parë, me të vërtetë ka pasur një shkelje lidhur me ritin e gjykimit, por, ashtu siç ka vlerësuar edhe Gjykata e Lartë, ajo nuk është e tillë sa të bëjë nul vendimin e marrë, pasi në thelb nuk ka sjellë asnjë pasojë ligjore.

30. Gjykata ka pohuar se procedurat gjyqësore që vendosin për kërkesat e prokurorit gjatë hetimit paraprak, të cilat ndërhyjnë në të drejtat themelore, si rregull, duhet të sigurojnë garancitë e duhura të procesit të rregullt për individin. Megjithatë, ligji i ka kufizuar disa prej garancive të procesit të rregullt në këtë fazë në raport me ato të gjykimit të themelit. Nga ky këndvështrim, Gjykata ka vlerësuar se ligjvënësi në këto raste, duke mos parashikuar dëgjimin e individit dhe një debat kontradiktor përpara gjyqtarit të hetimit paraprak, si dhe duke mos i dhënë efekt pezullues ankimit, ka synuar që masa të tilla hetimore, sikurse janë edhe ato të sekuestros, të mos pengohen nga individi me anë të taktikave të ndryshme përmes fshehjes, zhdukjes ose tjetërsimit të sendit objekt sekuestroje. Në këtë mënyrë sigurohet efektiviteti i masës, për rrjedhojë edhe rezultati i procedimit penal në tërësinë e tij. Për këtë arsye, disa nga garancitë e procesit të rregullt realizohen në gjykimin në shkallë të dytë, ku gjykata e apelit, e cila ka edhe kompetencën e marrjes dhe të shqyrtimit të provave, krahas zbatimit të ligjit, i jep mundësinë individit që ai vetë ose avokati i tij të dëgjohet për çdo kundërshtim në lidhje me kushtet në të cilat janë caktuar ose janë zbatuar masat hetimore (*shih vendimet nr. 33, datë 20.5.2025; nr. 21, datë 22.4.2025, të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Gjithashtu, referuar përmbajtjes së nenit 274 të KPP-së, që rregullon masën e sigurimit pasuror të sekuestros preventive, konstatohet se, kur ka rrezik që disponimi i lirë i një sendi që lidhet me veprën penale mund të rëndojë ose të zgjasë pasojat e saj, ose të lehtësojë kryerjen e veprave penale të tjera, me kërkesën e prokurorit, gjykata kompetente urdhëron sekuestrimin e tij me vendim të arsyetuar. Sipas nenit 276 të KPP-së, kundër vendimit për vënien ose mosvënien e sekuestros, cilido që ka interes mund të bëjë ankim, por kjo dispozitë nuk parashikon një formë të caktuar për shqyrtimin në këtë shkallë gjykimi.

32. Në rastin konkret, Gjykata vëren se gjykimi në shkallën e parë për caktimin e masës së sekuestros preventive ndaj pasurive në emër të kërkuesve është zhvilluar në seancë gjyqësore, por vetëm me praninë e prokurorit të çështjes. GJKKO-ja e Apelit ka marrë në shqyrtim pretendimin e kërkuesve lidhur me ritin e gjykimit në gjykatën e shkallës së parë, duke e gjetur atë të pabazuar. Ajo gjykatë ka evidentuar se legjislacioni procedural penal nuk parashikon norma të detajuara mbi

ritin e gjykimit të masave të sigurimit pasurore dhe, për këtë arsye, për to do të zbatohen, për aq sa është e mundur, rregullimet ligjore të masave të sigurimit personal. Për rrjedhojë, GJKKO-ja e Apelit ka çmuar se gjykata e shkallës së parë duhet të kishte zbatuar pikën 1 të nenit 244 të KPP-së për shqyrtimin e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme për caktimin e masës së sekuestros preventive, duke vendosur gjykimin e saj në dhomën e këshillimit dhe në praninë e palëve. Megjithatë, sipas gjykatës së apelit, kjo mospërputhje e ritit të gjykimit të ndjekur nga gjykata e shkallës së parë me pikën 1 të nenit 244 të KPP-së nuk është e tillë sa të bëjë nul vendimin e marrë, pasi, në thelb, nuk ka sjellë asnjë pasojë ligjore që të afektojë ligjshmërinë e tij ose të procesit. Po sipas saj, nuk mund të ketë kontradiktoritet në momentet e para të zbatimit të këtyre masave, për shkak se nga marrja dijeni do të pamundësohej zbatimi i tyre. Për sa i përket shqyrtimit të këtyre kërkesave në gjykatën e apelit, ajo gjykatë ka vlerësuar se duke qenë që gjykimi në shkallë të parë për këto lloj kërkesash shqyrtohet, si rregull, në dhomën e këshillimit, edhe shqyrtimi i ankimit nga ana e gjykatës së apelit realizohet, si rregull, në të njëjtën formë, për rrjedhojë ka vendosur që në rastin konkret ta shqyrtojë çështjen në dhomën e këshillimit. Pasi është njohur me ankimet, parashtrimet dhe provat e paraqitura nga palët, ajo gjykatë ka vlerësuar se çështja mund të shqyrtohej në gjendjen që ishin aktet në dhomën e këshillimit dhe se nuk kishte nevojë për caktimin e gjykimit në seancën gjyqësore me praninë e palëve (*shih faqet 143–145, të vendimit të GJKKO-së së Apelit*).

33. Edhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë i ka marrë në shqyrtim pretendimet për ritin e gjykimit në gjykatat e shkallëve më të ulëta, duke arsyetuar se legjislacioni penal nuk ka rregullime të detajuara për shqyrtimin e masave të sigurimit pasuror të sekuestros preventive, në këto kushte, për to do të jenë të zbatueshme në mënyrë komplementare rregullimet e neneve 88, 244 dhe 245 të KPP-së. Legjislacioni procedural penal, sipas saj, ka parashikuar një regjim juridik të "thjeshtëzuar mbi bazë të dokumenteve" për t'u zbatuar në ato raste kur diktohet nevoja për marrjen e një vendimi brenda afateve të shpejta, me qëllim garantimin e efektivitetit në sjelljen e rezultatit që synojnë këto lloj masash. Nga ana tjetër, ajo gjykatë ka sjellë në vëmendje se vetë dispozitat normuese të sekuestros preventive parashikojnë afate të shkurtra si në drejtim të ankimit të vendimit, ashtu edhe në drejtim të dhënies së vendimit nga gjykata e apelit. Ajo gjykatë ka arsyetuar se në gjykimin e këtyre masave, KPP-ja nuk ka parashikuar fazën e verifikimit të tyre, pasi gjykohen nga gjykata e shkallës së parë dhe bëhen pjesë e shqyrtimit gjyqësor rishikues vetëm nëpërmjet sistemit të ankimeve, për rrjedhojë ka vlerësuar se pika 1 e nenit 244 të KPP-së zbatohet në mënyrë plotësuese për ritin e gjykimit në shkallë të parë dhe në apel, sipas pikës 5 të nenit 426/a të KPP-së. Në vijim, Gjykata e Lartë ka vlerësuar se gjykimi në shkallë të parë i kërkesës së Prokurorisë së Posaçme për caktimin e sekuestros preventive shqyrtohet, si rregull, në dhomën e këshillimit dhe shqyrtimi i ankimit do të realizohet gjithashtu, si rregull, në dhomën e këshillimit (pa praninë e palëve), me kusht që të zbatohen rregullat për këtë rit gjykimi (njoftimi paraprak i palëve), në mënyrë që të kenë mundësi të paraqesin parashtrime me shkrim për shkaqet e ngritura në apel/apel kundërshtues. Në këtë mënyrë, ajo gjykatë ka arritur në përfundimin se, në ndryshim nga "oraliteti" dhe "publiciteti" që karakterizojnë procesin penal, në këto procese palëve u garantohet mundësia që të parashtrojnë argumentet dhe kundërshtimet e tyre me shkrim, në vend të parashtrimeve verbale. Pavarësisht këtij konkluzioni, Gjykata e Lartë ka theksuar se gjykata e apelit nuk ka asnjë pengesë që të disponojë për ritin e gjykimit, duke proceduar me kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore, sa herë që kryesisht ose me kërkesë të palëve, e çmon të nevojshme dëgjimin e tyre ose verifikimin e mëtejshëm të pjesës faktike të çështjes. Në rastin konkret, Gjykata e Lartë ka konstatuar se gjykata e apelit ka shqyrtuar ankimin e kërkuesve, duke i njoftuar ata paraprakisht për datën dhe orën e shqyrtimit të çështjes në dhomën e këshillimit, si

dhe u ka dhënë mundësi të paraqesin parashtrime me shkrim. Më tej, sipas saj, pasi është njohur me apelet e palëve, ka vlerësuar se çështja mund të shqyrtohej në gjendjen që ishin aktet në dhomën e këshillimit, duke çmuar se nuk ka nevojë për caktimin e gjykimit në seancë gjyqësore me praninë e palëve. Për sa i përket mënyrës së procedimit të GJKKO-së Shkallës së Parë, ajo gjykatë ka mbështetur arsyetimin e GJKKO-së së Apelit se shkelja e konstatuar nuk është e tillë që të cenojë vendimmarrjen e gjykatës për sa kohë nuk ka sjellë pasoja ligjore. Në vijim të këtij arsyetimi, ajo gjykatë i ka gjetur të pabazuara pretendimet e kërkuesve në lidhje me ritin e gjykimit në gjykatën e shkallës së parë dhe në gjykatën e apelit (*shih paragrafët 29–33, të vendimit të Kolegjit Penal*).

34. Në këto kushte, si dhe nën dritën e standardeve të mësipërme kushtetuese, Gjykata rithekson se shqyrtimi në gjykatën e shkallës së parë nuk parashikon dëgjimin e individit dhe një debat kontradiktor përpara gjyqtarit të hetimit paraprak, garanci e cila realizohet në gjykimin në shkallë të dytë, ku gjykata e apelit i jep mundësinë individit që ai vetë ose avokati i tij të dëgjohet për çdo kundërshtim në lidhje me kushtet në të cilat janë caktuar ose zbatuar masat hetimore. Gjithsesi, ajo (Gjykata) vlerëson se, ashtu sikurse ka theksuar edhe Gjykata e Lartë, në rastin konkret kërkuesit e kanë ushtruar lirisht të drejtën e ankimit në gjykatën e apelit, duke realizuar në këtë shkallë të gjykimit garancitë e procesit të rregullt ligjor që lidhen me të drejtën e aksesit, si dhe me atë për t'u dëgjuar e për t'u mbrojtur dhe parimin e barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit, pasi atyre u është dhënë mundësia të paraqesin me shkrim parashtrimet dhe provat ku mbështesin pretendimet e tyre, pra u është dhënë mundësia që nëpërmjet avokatit të tyre të dëgjohen për çdo kundërshtim në lidhje me kushtet në të cilat janë caktuar ose zbatuar masat hetimore dhe të marrin përgjigje për to. Po kështu, kërkuesit e kanë ushtruar lirisht edhe të drejtën e ankimit në Gjykatën e Lartë, e cila ka marrë në shqyrtim themelin e pretendimeve të tyre në rekurs, duke i gjetur ato të pabazuara, duke lënë në fuqi, për rrjedhojë, vendimin e gjykatës së apelit. Për këto arsye, pretendimet për cenimin e së drejtës së aksesit dhe të parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit janë haptazi të pabazuara.

35. Për pretendimin e cenimit të *parimit të prezumimit të pafajësisë dhe të paanësisë*, kërkuesit kanë pretenduar se GJKKO-ja e Apelit ka shtuar si elemente mbështetëse për nevojat e sigurimit kryerjen e veprës penale nga të hetuarit nën formën e një grupi të strukturuar kriminal, duke rikualifikuar faktin penal sipas neneve 143, 287 dhe 334 të KP-së, ndërkohë që prokurori në kërkesën për caktimin e masës është mjaftuar me bashkëpunimin e thjeshtë. Ajo gjykatë ka tejkaluar rolin e saj duke e konfonduar me rolin e gjykatës së seancës paraprake. Përsëritja e të njëjtit qëndrim është tregues i qartë se GJKKO-ja e Apelit e ka shqyrtuar çështjen me bindjen se kërkuesi Redi Molla është fajtor dhe se veprat e kryera nga ai janë më të rënda se ato të pretenduara nga Prokuroria e Posaçme, duke e rënduar pozitën e tij. Ajo gjykatë e ka tejkaluar pragun e shfaqjes së një mendimi apo sugjerimi mbi formën e bashkëpunimit ose kualifikimin e faktit penal, duke u udhëhequr nga një bindje e plotë se ai është fajtor dhe tenton ta orientojë Prokurorinë e Posaçme që të veprojë sipas bindjes së saj. Po e njëjta gjykatë ka mbajtur edhe herë të tjera këtë qëndrim, në caktimin e masës së sigurimit personal për kërkuesin Redi Molla, por në atë rast kjo parregullsi është korrigjuar nga Gjykata e Lartë, e cila e ka prishur vendimin e gjykatës së apelit dhe e ka dërguar çështjen për rishqyrtim. Për këtë argument të fundit kërkuesi ka pretenduar edhe cenimin e parimit të sigurisë juridike.

36. Gjykata vëren se në thelb të pretendimit të kërkuesve, të cilin ata e ndërlidhin me cenimin e disa parimeve kushtetuese (parimit të prezumimit të pafajësisë, së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj dhe e paanshme, parimit të mosrëndimit të pozitës të të pandehurit dhe atë të sigurisë juridike) është argumenti se GJKKO-ja e Apelit ka rënduar pozitën e tyre duke shtuar si nevojë sigurimi rrethanën e kryerjes së veprës në bashkëpunim të posaçëm, të

papretenduar nga Prokuroria e Posaçme dhe se Gjykata e Lartë për këtë fakt, në rastin e caktimit të masës së sigurimit personal ndaj kërkuesit Redi Molla, e ka kthyer çështjen për rishqyrtim.

37. Gjykata vëren se GJKKO-ja e Apelit ka orientuar Prokurorinë e Posaçme për të hetuar në drejtim të bashkëpunimit si grup i strukturuar kriminal, pasi, duke pasur parasysh përmasën e fitimeve nga ushtrimi i këtij aktiviteti ekonomik, ajo gjykatë ka vlerësuar se ka dyshime të arsyeshme se personat e hetuar ose jo deri më tani, mes tyre edhe kërkuesi Redi Molla, kanë konsumuar elementet e veprës penale të parashikuara nga paragrafi tretë i nenit 143 të KP-së, vepër penale kjo e kryer në kuadër të grupit të strukturuar kriminal, sipas pikës 4, të nenit 28 dhe pikës 1, të nenit 334 të KP-së. Nga ana tjetër, ajo gjykatë ka konstatuar se fitimet kriminale të gjeneruara nga vepra penale janë ricikluar në qarkullimin civil dhe, sikurse ka konkluduar edhe në vendimin e datës 3.5.2024 (për vazhdimin e masës së sigurimit "Arresti në burg" ndaj kërkuesit Redi Molla), sërish ka vlerësuar se ekziston dyshimi i arsyeshëm që personat e proceduar penalisht ose të paproceduar ende, kanë konsumuar elementet e veprës penale të parashikuar nga pika 2, e nenit 287 të KP-së, të kryer në kuadër të grupit të strukturuar kriminal, të parashikuar nga pika 4, e nenit 28 dhe pika 1, e nenit 334 të KP-së. Megjithatë, GJKKO-ja e Apelit ka evidentuar se hetimet kanë identifikuar një rreth tjetër personash të përfshirë, por të paproceduar, duke qartësuar ende më shumë përmasat e mëdha të shtrirjes së bashkëpunëtorëve. Në këto kushte, ajo gjykatë ka arsyetuar se mbetet detyrë kushtetuese e organit procedues që në vijim të hetimeve të ketë në fokus procedimin penal të secilit bashkëpunëtor dhe veprimin e një grupi të strukturuar kriminal si operator ekonomik pjesëmarrës në prokurime publike *(shih paragrafët 257–261, faqet 146, 147, të vendimit të GJKKO-së së Apelit)*. Gjykata e Lartë ka arsyetuar se ndonëse formalisht pretendimi i kërkuesve qëndron, ka çmuar se, në thelb, nuk ka asnjë kontradiktë me të dhe me kërkesën e Prokurorisë së Posaçme lidhur me ekzistencën e kushteve dhe të nevojave në rastin konkret për caktimin e masës së sekuestros preventive, duke i vlerësuar vendimet e gjykatave të posaçme plotësuese të njëra-tjetrës (*shih paragrafin 40, të vendimit të Gjykatës së Lartë)*.

38. Në këtë pikë, Gjykata rithekson se shtimi dhe ndryshimi i akuzës janë veprime procedurale formale të cilat kryhen nga organi procedues, pasi individi merr cilësinë e të pandehurit me aktin e njoftimit të akuzës nga prokurori, në të cilin, në përputhje me nenin 34 të KPP-së, tregohen të dhënat e mjaftueshme. Edhe në raste të ngjashme, Gjykata është shprehur se GJKKO-ja e Apelit nuk e ka rënduar pozitën e kërkuesit, por ka vlerësuar në mënyrë autonome rëndësinë e fakteve konform natyrës së veprave penale për të cilat ai dyshohet. Arsyetimi i gjykatës nuk përbën rëndim të pozitës të të pandehurit, pasi është organi i akuzës ai që vlerëson gjatë hetimit paraprak se për cilat vepra penale do të ngrejë përfundimisht akuzë *(shih vendimin nr. 7, datë 28.1.2026, të Gjykatës Kushtetuese)*.

39. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se edhe në rastin në shqyrtim, ashtu sikurse arsyeton edhe Gjykata e Lartë, nuk rezulton që gjykatat e posaçme të kenë dhënë një vendim që bie ndesh me parashikimet ligjore të nenit 274 të KPP-së, si dhe nuk evidentohet që interpretimi i bërë nga ato të jetë zgjeruar në atë masë sa të cenojë garancitë procedurale të vendosura nga KPP-ja, duke rënduar, në rastin konkret, pozitën e kërkuesit. Prandaj, pretendimi i kërkuesve për secilin prej parimeve kushtetuese se pretendon se i është cenuar nuk mund të merret në shqyrtim.

40. Kërkuesit kanë pretenduar edhe cenimin e *standardit të arsyetimit të vendimit* dhe *së drejtës së pronës.* Gjykata, duke qenë se në jurisprudencën e saj ka pohuar se për të vlerësuar nëse ka pasur ose jo cenim të të drejtave substanciale, bazohet në arsyetimin e vendimeve të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, për sa kohë që në bazë të parimit të *subsidiaritetit* u takon edhe atyre respektimi i standardeve kushtetuese (*shih vendimet 79, datë 12.11.2024; nr. 29, datë 16.4.2024; nr. 19, datë 21.3.2024, të Gjykatës Kushtetuese*), si dhe bazuar edhe në thelbin dhe natyrën e

pretendimeve të parashtruara në ankimin kushtetues individual, do të shqyrtojë, në vijim, *në aspektin substancial,* pretendimet për cenimin e së drejtës së pronës të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për cenimin e së drejtës së pronës të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit

41. Kërkuesit kanë pretenduar se masa e sekuestros preventive nuk plotëson kriteret e nenit 274 të KPP-së, sipas të cilit duhet të provohet lidhja e sendit për të cilin kërkohet të vendoset masa e sigurimit pasuror me veprën penale, pasi nuk ka asnjë indicie ose provë për të arritur në konkluzionin që pasuritë janë produkte të veprës penale. Lidhur me kuotën e kërkueses, shoqërisë "Restur", nuk është hetuar dhe as arsyetuar se ku është dyshimi që kjo pasuri mund të jetë krijuar nga produktet e veprës penale. Lidhur me kërkuesen, shoqërinë "Mediterranean Investment Group", rezulton se nga krijimi i saj e deri në vitin 2023 nga ana e të ndjerit S. M. është kaluar në shoqëri vlera 564.000 euro në kuadër të zhvillimit të projektit, e cila nuk është verifikuar për burimin e saj, që të përligjte vënien e sekuestros mbi të. Ndërhyrja në të drejtën e pronës private është shtrirë përtej personit nën hetim, vetëm për shkak të lidhjes familjare dhe në mungesë të plotë të të dhënave ose të një analize nga gjykatat. Në këtë kuptim, është e paqartë lidhja dhe përfshirja në sekuestro edhe e pasurisë nr. 5/523. Kufizimi i së drejtës së pronësisë së kërkuesve është bërë përmes një mjeti të papërshtatshëm, siç është sekuestroja preventive, në kushtet kur qëllimi i kërkuar nga neni 274 i KPP-së mund të arrihet me mënyra të tjera, si ndalimi i tjetërsimit të pasurive dhe i kuotave të sekuestruara, duke bërë shënimet përkatëse në regjistrin e pasurive të paluajtshme dhe në regjistrin tregtar. Kërkuesi Redi Molla është i kufizuar nga disponimi i pasurive edhe si pasojë e kufizimit të lirisë. Gjykatat nuk kanë paraqitur një lidhje të qartë midis pasurive të sekuestruara dhe veprës penale, dhe nuk kanë specifikuar se në cilën prej kategorive të nenit 274 të KPP-së dhe nenit 36 të KP-së përfshihen sendet e sekuestruara. Duke pasur parasysh faktin se disa nga pasuritë e sekuestruara janë në pronësi të personave të tretë që nuk kanë lidhje me procedimin penal (kërkuesja Ollga Molla), organi i akuzës dhe gjykatat duhet të kishin arsyetuar me argumente konkrete arsyet e vendosjes së sekuestros për këto pasuri. Gjykatat kanë arsyetuar në mënyrë të përgjithshme mbi kushtet dhe kriteret për caktimin e masave të sigurimit pasuror, duke mos arsyetuar se pse një kufizim i tillë i tagrave të pronësisë ishte mjeti i vetëm për të siguruar qëllimin e synuar, në kuptim të parimit të proprorcionalitetit. Çdo masë që mund të ndërhyjë në të drejtat e individëve nën hetim dhe, sidomos atyre që nuk janë nën hetim, duhet të arsyetohet në drejtim të rezultateve parandaluese që synohen të arrihen. Sekuestroja duhet të urdhërohet si mjeti i fundit, në mungesë të alternativave që janë në të njëjtën masë efektive, ndërkohë që kufizimi duhet të argumentohet në lidhje me shkaqet që e justifikojnë atë. Për shkak të masës është cenuar edhe e drejta për pronë private, e garantuar nga neni 41 i Kushtetutës, pasi ndërhyrja nuk është e bazuar në ligj (sepse legjislacioni penal lejon kufizimet e kësaj të drejte vetëm ndaj personave që dyshohet se kanë kryer veprën penale), dhe as nuk plotëson kriterin e ligjshmërisë (pasi nuk plotëson kriteret e nenit 274 të KPP-së).

42. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, ka prapësuar se masat e caktuara ndaj pasurive në fjalë nuk janë dukshëm arbitrare ose joproporcionale. Gjykatat kanë arsyetuar në rastin konkret rreth domosdoshmërisë, proporcionalitetit dhe përshtatshmërisë, si dhe kanë mbajtur në konsideratë se masa e sigurimit pasuror përmbush qëllimin për të cilin është caktuar. Gjykata e Lartë ka arsyetuar se kufizimet/ndërhyrjet në të drejtat dhe liritë kushtetuese lidhur me pasurinë, për shkak të caktimit të masës së sigurimit pasuror, janë rrjedhojë e baraspeshimit të drejtë midis interesit publik dhe interesave personalë të personave të prekur nga kjo ndërhyrje. Gjykatat e posaçme, në thelb, kanë kontradiktë në vendimmarrjet e tyre lidhur me ekzistencën e kushteve dhe

të nevojave për caktimin e masës në rastin konkret. Ato kanë analizuar në mënyrë cilësore indiciet dhe provat që mbështesin kërkesën e Prokurorisë së Posaçme. Edhe Gjykata e Lartë ka arsyetuar se objekt sekuestrimi mund të jetë çdo e mirë (send), për këdo që i përket, përfshirë edhe një person që nuk ka lidhje me krimin, për sa kohë që ajo pasuri është e lidhur me krimin. Pretendimi për cenimin e së drejtës së pronës në drejtim të proporcionalitetit të ndërhyrjes është i pabazuar, pasi masat e caktuara ndaj pasurive në fjalë nuk janë dukshëm arbitrare ose joproporcionale.

43. Gjykata ka theksuar se e drejta e pronës, e sanksionuar në nenin 41 të Kushtetutës, përfshin tri garanci që duhet të zbatohen në shqyrtimin e pretendimeve për cenimin e saj: *garancia e parë* ka të bëjë me parimin e gëzimit të qetë të pronës, e cila ka natyrë të përgjithshme; *garancia e dytë* ka të bëjë me kufizimet e lejueshme për të drejtën e pronës; *garancia e tretë* ka të bëjë me të drejtën e autoriteteve publike për të kontrolluar përdorimin e pronës në përputhje me interesin e përgjithshëm (*shih vendimet nr. 18, datë 19.3.2024; nr. 53, datë 31.10.2023; nr. 25, datë 13.10.2022, të Gjykatës Kushtetuese*).

44. Gjykata fillimisht vëren se masa e kundërshtuar e sekuestros preventive është marrë në kuadër të procedimit penal, mbi dyshimet se kërkuesi Redi Molla ka marrë përfitime të parregullta përgjatë kohës që ka ushtruar funksionin publik, për vete ose persona të tjerë, se ka bërë deklarim të rremë dhe ka fshehur pasurinë, si dhe ka kryer veprime, me qëllim fshehjen ose mbulimin e origjinës së pasurisë së paligjshme, të përfituar si pasojë e korrupsionit ose burimeve të tjera të paligjshme. Në rastin konkret, masa e sekuestros preventive për pasuritë e paluajtshme e të luajtshme të kërkuesit Redi Molla dhe kërkueses Ollga Molla ka vendosur një ndalim të përkohshëm në të drejtën për gëzimin dhe disponimin e këtyre pasurive, për rrjedhojë ka sjellë kufizim të së drejtës së tij kushtetuese të pronës private.

45. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka pohuar se ndërhyrja që vendimi i sekuestrimit bën tek e drejta e pronës duhet: të jetë e ligjshme, në kuptimin që të jetë vendosur me ligj dhe të ndjekë një qëllim të ligjshëm, në kuptim të interesit publik; të vendosë një "ekuilibër të drejtë" midis kërkesave të interesit të përgjithshëm dhe garancive për mbrojtjen e së drejtës së pronës; të respektojë një marrëdhënie të arsyeshme proporcionaliteti midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit të ndjekur. Ekziston një hapësirë e gjerë vlerësimi për autoritetet publike në lidhje me zgjedhjen e mjeteve dhe atë çfarë konsiderohet në interes të përgjithshëm, me përjashtim të rasteve kur vendimi është haptazi i paarsyeshëm (*shih vendimet nr. 20, datë 11.4.2025; nr. 29, datë 16.4.2024; nr. 18, datë 19.3.2024, të Gjykatës Kushtetuese*).

46. E drejta e pronës private, ashtu si dhe të drejtat dhe liritë e tjera, nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor (neni 42 i Kushtetutës), i cili përfshin, mes të tjerash, edhe detyrimin për një vendim gjyqësor të arsyetuar, si element thelbësor i një vendimi të drejtë. Në lidhje me këtë standard kushtetues, në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Ai, në çdo rast, duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje (*shih vendimet nr. 43, datë 27.12.2022; nr. 41, datë 22.12.2022; nr. 29 datë 1.11.2022, të Gjykatës Kushtetuese*). Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë, dhe duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie ose kontradiksion të hapur ose të fshehtë (*shih vendimet nr. 19, datë 1.4.2021; nr. 20, datë 13.4.2012; nr. 38, datë 30.12.2010, të Gjykatës Kushtetuese*). Arsyetimi duhet domosdoshmërish të plotësojë kriteret minimale ligjore të përcaktuara dhe të mos ketë të meta të tilla serioze që cenojnë standardin e vendimit gjyqësor të arsyetuar. Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe

u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 51, datë 20.6.2024; nr. 19, datë 7.7.2022; nr. 3, datë 20.1.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

47. Në këtë kontekst, Gjykata ka theksuar se është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të interpretojnë ligjin për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës. Gjykata nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi, por ajo ndërhyn atëherë kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e kujdesshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose është i tillë që gjykimin e bën të padrejtë *(shih vendimet nr. 59, datë 14.11.2023; nr. 30, datë 29.5.2023; nr. 29, datë 1.11.2022, të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, Gjykata është shprehur se në rastet kur pretendohet se vendimet gjyqësore objekt kontrolli përmbajnë elemente arbitrariteti, Gjykata nuk vë në dyshim të drejtën e gjykatave të zakonshme për të interpretuar ligjin për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, por kufizohet në identifikimin e gabimeve ligjore e faktike të dukshme, të cilat shkojnë përtej pretendimeve për interpretim të gabuar të ligjit (që mbeten për t'u zgjidhur në sferën e gjykimit të gjykatave të zakonshme), por që gjithsesi cenojnë të drejtën e kërkuesit për të pasur një gjykim të drejtë (*shih vendimin nr. 11, datë 11.2.2026, të Gjykatës Kushtetuese*).

48. Në kuptim të këtyre standardeve kushtetuese dhe bazuar në pretendimet e ngritura nga kërkuesit në çështjen konkrete, Gjykata do të analizojë nëse gjykatat e posaçme, në vendimet për caktimin e masës së sekuestros, kanë arsyetuar në mënyrë të mjaftueshme dhe të qartë si për lidhjen e kësaj mase me objektivin e saj, që është parandalimi i pasojave të mëtejshme të veprës penale, ashtu edhe për respektimin e kritereve që lejojnë ndërhyrjen në të drejtën kushtetuese të pronës private.

49. Bazuar në sa më sipër, Gjykata nuk vë në dyshim se lufta kundër kriminalitetit është një çështje me interes publik, si një nga kriteret që justifikon ndërhyrjen në të drejtat themelore të individit, përfshirë atë të pronës private dhe se rregullat procedurale penale që lejojnë sekuestrimin e pasurisë i shërbejnë mbarëvajtjes së procedimit penal, në kuptimin e ruajtjes së rendit dhe të sigurisë publike nga veprimtaria kriminale. Duke pasur në konsideratë prezumimin e ekzistencës së interesit publik për ndërhyrjen në të drejtat themelore, por edhe hapësirën e kontrollit kushtetues, si mjeti i fundit i brendshëm në dispozicion të individit, për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive themelore, që shtrihet në verifikimin e respektimit të garancive procedurale të përshtatshme dhe efektive për mbrojtjen nga arbitrariteti në ushtrimin e pushtetit publik që çojnë në shkeljen e të drejtave substanciale, si dhe rolin e saj subsidiar, ajo ndalet në vlerësimin nëse interpretimi dhe zbatimi i ligjit nga gjykatat e zakonshme ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë.

50. Për shkak se masa e sekuestros me karakter pasuror përbën një mjet kontrolli të pasurisë së individit nga shteti dhe, në disa raste, për nga kohëzgjatja, mund të përbëjë edhe heqje të saj, si dhe duke pasur parasysh garancitë procedurale që duhet të sigurohen në këtë fazë të procedurave penale, arsyetimi i vendimeve gjyqësore i lejon palës së prekur jo vetëm që të njihet me shkaqet e kufizimit të së drejtës substanciale, por edhe që ta kundërshtojë këtë masë efektivisht përpara gjykatave më të larta. Për rrjedhojë, edhe në rastin konkret, Gjykata do të vlerësojë nëse vendimet gjyqësore që kanë pranuar kërkesën e Prokurorisë së Posaçme për sekuestrimin e pasurive të kërkuesve objekt ankimi përmbajnë bazë të mjaftueshme dhe të arsyeshme për të justifikuar këtë ndërhyrje në të drejtën e pronës.

51. Gjykata në jurisprudencën e saj është ndalur edhe në natyrën dhe pasojat e sekuestros preventive, që rregullohet nga parashikimet e neneve 274–276 të KPP-së dhe që synon heqjen e sendit nga disponimi i lirë i subjektit që e zotëron atë, duke vendosur mbi të (sendin) një detyrim të caktuar. Sipas nenit 274 të KPP-së, sekuestroja vendoset nga gjykata, me kërkesë të prokurorit, kur ka rrezik që disponimi i lirë i një sendi që lidhet me veprën penale mund të rëndojë ose të zgjasë pasojat e saj, ose të lehtësojë kryerjen e veprave penale të tjera, ashtu edhe për sendet, produktet e veprës penale dhe çdo lloj pasurie tjetër që lejohet të konfiskohet, sipas nenit 36 të KP-së. Sekuestroja preventive ka qëllim parandalues, pra synon të ndërpresë kryerjen e një vepre penale ose të parandalojë kryerjen e veprave penale të reja. Nga ana tjetër, kjo masë synon të garantojë efektivitetin e një konfiskimi të mundshëm të mëvonshëm, duke bërë paraprakisht të padisponueshme, në një fazë që i paraprin dënimit, sendet që kanë shërbyer ose kanë qenë të destinuara për të kryer veprën penale, që janë produkti ose të ardhurat, ose sendet, prodhimi, përdorimi, mbajtja ose tjetërsimi i të cilave përbën vepër penale (sekuestroja e drejtpërdrejtë). Sekuestroja preventive vendos një pengesë/kufizim mbi sendin, me qëllim garantimin e arritjes së qëllimit të procedimit penal deri në marrjen e vendimit përfundimtar të fajësisë së autorit të veprës penale. Sekuestroja preventive mund të urdhërohet jo vetëm mbi sendet që kanë një lidhje specifike me faktin penal që ndiqet penalisht, por edhe "për ekuivalencë", pra edhe mbi çdo pasuri tjetër, vlera e së cilës i korrespondon asaj të produkteve të veprës penale (neni 36, pika 1, shkronja "ç", i KP-së). Referuar përmbajtjes së kësaj dispozite, sikundër praktikës gjyqësore, është e pranueshme që masa kufizuese e sekuestros të prekë edhe sende ose pasuri, origjina e të cilave nuk vihet në diskutim në atë procedim penal, të cilat janë fituar ose kanë ekzistuar edhe përpara fakteve penale për të cilat ka filluar procedimi penal, në kuadër të të cilit është vendosur masa e sekuestros, pra që nuk kanë një lidhje të posaçme me faktet objekt të veprës penale. Në këtë kuptim, Gjykata ka vlerësuar se për të respektuar kriteret kushtetuese të kufizimit me ligj dhe standardet e gjykimit të drejtë, prokuroria në kërkesën për caktimin e masës së sekuestros dhe gjykatat e zakonshme në shqyrtimin dhe vlerësimin e saj, duhet të specifikojnë dhe të saktësojnë se në cilën prej kategorive, sipas nenit 274 të KPP-së dhe nenit 36 të KP-së, përfshihet secili prej sendeve që kërkohet të sekuestrohet, pra nëse bëhet fjalë për sende ose produkte të veprës penale (sekuestroja e drejtpërdrejtë) ose për sekuestrim "për ekuivalencë" të sendeve të tjera që nuk hyjnë në kategorinë e atyre që lidhen drejtpërdrejt me veprën penale. Në rastin kur, për shkak se është e pamundur të rikuperohen sendet e vendosura në mënyrë të paligjshme, kërkohet aplikimi i shkronjës "ç të pikës 1 të nenit 36 të KP-së, është e nevojshme të saktësohet individualisht çdo send/pasuri që sekuestrohet për shkak të ekuivalencës së vlerës së tij me atë të produkteve të veprës penale. Për këtë qëllim nevojiten të kryhen disa veprime që kanë të bëjnë si me vlerësimin se sendi/produkti i veprës penale është i pamundur të gjendet ose të rikuperohet, ashtu edhe me vlerësimin e secilit send që kërkohet të sekuestrohet "për ekuivalencë" për të konkluduar masën në të cilën është e nevojshme të shtrihet sekuestroja (*shih vendimin nr. 20, datë 11.4.2025, të Gjykatës Kushtetuese)*.

52. Për rrjedhojë, sekuestroja "për ekuivalencë", në ndryshim nga sekuestroja e drejtpërdrejtë e sendeve/produkteve të veprës penale, duke mos qenë e identifikueshme për shkak të lidhjes me vetë veprën, kërkon zbatimin e disa filtrave që kanë të bëjnë me: i. zbatimin e saj vetëm kur është e pamundur të identifikohen ose të gjenden sendet që lidhen me veprën penale; ii. ajo duhet të shtrihet, për aq sa është e mundur, në pasuri të të njëjtit lloj; iii. duhet të synojë të jetë sa më pak e dëmshme në kuptim të qëllimit që synon të arrijë. Kjo e fundit kërkon nga gjykatat që të saktësojnë se mbi cilat tagra mund të shtrihet kufizimi dhe nëse sekuestrimi i plotë i sendit, pra kufizimi i së drejtës së pronës në të gjitha tagrat e saj, përputhet me qëllimin e kësaj mase dhe nëse, në kuptim të kriterit të proporcionalitetit, në drejtim të përshtatshmërisë së masës, qëllimi që

synohet të arrihet nuk do të ishte i mundur të përmbushej edhe përmes kufizimit vetëm të një ose më pak tagrave të së drejtës së pronës. Në ato raste kur është e zbatueshme sekuestroja "për ekuivalencë" gjyqtari duhet të arsyetojë në mënyrë të përshtatshme pamundësinë e arritjes të të njëjtit rezultat me një ndërhyrje më pak kufizuese, si për sa i përket shtrirjes së saj në sendet dhe pasuritë që do të preken, ashtu edhe në tagrat e vet së drejtës substanciale të pronës private (*shih vendimin nr. 20, datë 11.4.2025, të Gjykatës Kushtetuese)*.

53. Në përputhje jo vetëm me parimin e proporcionalitetit të ndërhyrjes, por edhe të prezumimit të pafajësisë, çdo masë që mund të ndërhyjë në të drejtat e individëve nën hetim gjatë procedurave penale, pra përpara dhënies së një vendimi përfundimtar të fajësisë, duhet të arsyetohet në drejtim të rezultateve parandaluese që synohen të arrihen. Sekuestroja, si çdo masë tjetër që kufizon ushtrimin e lirë të të drejtave të garantuara kushtetutshmërish, duhet të urdhërohet vetëm si mjeti i fundit, në mungesë të alternativave që janë në të njëjtën masë efektive, ndërkohë që kufizimi duhet të argumentohet në lidhje me shkaqet që e justifikojnë atë. Kjo nënkupton se prokurori në kërkesën për caktimin e masës dhe më pas gjykata gjatë shqyrtimit të saj duhet të verifikojnë dhe të arsyetojnë se sekuestroja që shtrihet mbi sende të tjera që nuk kanë lidhje me veprën penale dhe vetë vlera e sendeve të sekuestruara "për ekuivalencë" është proporcionale me "çmimin" ose "fitimin" e veprimtarisë së paligjshme, me qëllim shmangien e një kufizimi arbitrar të së drejtës së pronës private. Edhe pse këto masa kufizuese gjejnë mbështetje kushtetuese (nenet 41 dhe 17 të Kushtetutës), pasi synojnë realizimin e një interesi publik, në mënyrë që dëmi në të drejtat individuale të jetë në përputhje me garancitë kushtetuese, ai nuk duhet të jetë përtej asaj që është e pashmangshme (*shih vendimin nr. 18, datë 19.3.2024, të Gjykatës Kushtetuese*). Kufizimi nuk mund të shkojë përtej asaj që synohet dhe që është e nevojshme për realizimin e qëllimit të parashikuar nga dispozitat penale dhe duhet t'i përgjigjet masës së proporcionalitetit në kuptim të *quantum* të pasurisë/të ardhurave që burojnë nga veprimtaria e paligjshme. Çdo tejkalim, në mungesë të analizës së këtyre elementeve, do të përbënte cenim të vet thelbit të së drejtës së pronës private, duke e bërë ndërhyrjen arbitrare (*shih vendimin nr. 20, datë 11.4.2025, të Gjykatës Kushtetuese)*.

54. Si parim, masa e sekuestros preventive synon të prekë sendin që dyshohet se është fituar në mënyrë të paligjshme dhe vetëm nëse është e pamundur të gjendet ose të rikuperohet ai, atëherë synohet që të rikuperohen pasuri të tjera, vlera e të cilave u korrespondon atyre të produkteve të veprës penale. Kjo nënkupton se zbatimi i sekuestros së drejtpërdrejtë mbi vetë produktet e veprës penale ose të ardhurat e saj nuk lejon edhe zbatimin në të njëjtën kohë dhe paralelisht, pra për të njëjtin qëllim, edhe të sekuestros "për ekuivalencë" të pasurive të tjera të individit, subjekt i procedimit penal (*shih vendimin nr. 20, datë 11.4.2025, të Gjykatës Kushtetuese)*.

55. Duke pasur parasysh qëllimin e sekuestros "për ekuivalencë", si një masë që i paraprin konfiskimit të pasurisë, ajo duhet të synojë atë lloj sendi/aseti që është në gjendje të realizojë më lehtë ekuivalencën në vlerë me produktet e veprës penale. Nga ana tjetër, për sa kohë që masa shtrihet mbi sende të tjera, të ndryshme nga sendi ose produktet e veprës penale, pra sende për të cilat nuk verifikohet dhe as nuk certifikohet në atë procedim penal ligjshmëria e burimit të tyre, duhet të synohet të preken sa më pak tagra të sendit, në mënyrë që kjo masë, nga njëra anë, të jetë sa më pak e dëmshme për individin dhe, nga ana tjetër, të sigurojë qëllimin e saj, që është ai për të shmangur tjetërsimin/humbjen e sendeve në pritje të përfundimit të procesit penal. Për këtë qëllim prokuroria duhet të argumentojë në mënyrë të qartë përpara gjykatës se çfarë ka rezultuar nga hetimi, mënyrën sesi po veprohet dhe vlerësimin e kryer për të konkluduar si për vlerën e produkteve/sendeve/të ardhurave të dyshuara të veprës penale, ashtu edhe për vlerën e tyre korresponduese me atë të sendit për të cilin kërkohet nga gjykata caktimi i masës kufizuese,

sikundër tagrat që synohen të preken/kufizohen në kuptim të proporcionalitetit të ndërhyrjes. Në këtë kuptim, gjykatat e zakonshme duhet të tregojnë kujdes në zbatimin e nenit 274 të KPP-së të lidhur me nenin 36, pika 1, shkronja "ç", të KP-së, duke bërë, për aq sa është e mundur, vlerësimin e mënyrës së zbatimit të këtyre dispozitave në drejtim të ekuivalencës me produktet e dyshuara të veprës penale (*shih vendimin nr. 20, datë 11.4.2025, të Gjykatës Kushtetuese)*.

56. Thënë sa më sipër, në rastin konkret, Gjykata do të ndalet, në vijim, në mënyrën sesi gjykatat e posaçme kanë zbatuar kriteret e mësipërme në vendosjen e masës së sekuestros për pasuritë që janë vlerësuar se përbëjnë produkte të veprave penale dhe atyre që janë sekuestruar si vlerë ekuivalente e produktit të veprave penale, si dhe në mënyrën sesi kanë argumentuar ato në drejtim të kufizimit të së drejtës së pronës private të kërkuesve për shkak të kësaj mase.

57. Gjykata vëren se në kuadër të procedimit penal është formësuar dyshimi i arsyeshëm se gjatë kohës që ka ushtruar funksionin publik, kërkuesi Redi Molla ka konsumuar veprat penale të parashikuara nga nenet 258, paragrafi i dytë, dhe 259, paragrafi i dytë, të KP-së (shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tenderë dhe në ankande publike dhe korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike). Në lidhje me veprën penale të parashikuar nga nenet 257/a, paragrafi i dytë, dhe 25 të KP-së (refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave privatë të personave që kanë detyrimin ligjor për deklarim), ka lindur dyshimi për fshehje të faktit se kërkuesi Redi Molla, së bashku me shtetasin M. Q., kanë në zotërim të tërthortë subjektin e interesuar, shoqërinë "5D", si dhe dyshimi se ai zotëron në mënyrë të fshehtë pasuritë e paluajtshme të regjistruara në emër të prindërve të tij. Për këto dyshime, Prokuroria e Posaçme ka kërkuar, ndër të tjera, sekuestrimin e interesave pasurorë të kërkuesit Redi Molla në dy shoqëri tregtare, sikundër të dy pasurive të paluajtshme, në pronësi të prindërve të tij. Duke qenë se pasuritë e sekuestruara të shoqërisë "5D" nuk janë objekt i këtij ankimi kushtetues individual (*shih sipër paragrafin 22*), Gjykata, në vijim, do të ndalet në analizën e gjykatave të posaçme për pasuritë e tjera të sekuestruara.

58. Në lidhje me *dy pasuritë e paluajtshme* (nr. 5/523 dhe nr. 5/648) të ndodhura në Tiranë, në pronësi të prindërve të kërkuesit Redi Molla, të sekuestruara nga Prokuroria e Posaçme, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka konsideruar se ka të dhëna të mjaftueshme se përbëjnë *produkte të veprave penale objekt procedimi*, pasi ato janë fituar pjesërisht me burime financimi që rrjedhin nga produkte të veprës penale (nga fonde të shoqërisë "5D"). Për to është vlerësuar se plotësohen kriteret ligjore të përcaktuara nga neni 274/1 i KPP-së dhe neni 36, pika 1, shkronja "b", i KP-së në lidhje me pikat 2 dhe 3 të atij neni. Në këtë konkluzion është arritur pasi është vlerësuar se ka rezultuar e provuar që: i. dy këste të blerjes së këtyre pasurive janë paguar nga shoqëria "5D" (administruar mandatpagesa për këstin e dytë në vlerën 100.000 euro, me objekt "*pagesë kësti 2 për blerje pasuritë nr. 5/523 dhe nr. 5/648, me adresë "Pazari i ri" Tiranë*"; ii. kanë rezultuar të dhëna të nevojshme dhe të mjaftueshme për të konkluduar se shoqëria "5D" kontrollohet plotësisht nga kërkuesi Redi Molla dhe duke mbartur interesa të fshehur në këtë person juridik, ka dyshime të arsyeshme se këto dy pasuri jo vetëm janë blerë pjesërisht me vlera monetare nga shoqëria "5D", por edhe se përbëjnë pasuri të fshehura të tij. Në këtë konkluzion është arritur, pasi: i. të paktën dy këste në vlera të konsiderueshme janë paguar nga shoqëria e cila mbart interesa të drejtpërdrejtë pasurorë kërkuesi Redi Molla; ii. ai njihet nga qiramarrësit e pasurive si pronar i tyre; iii. ato janë rikonstruktuar, duke investuar vlera të konsiderueshme, po nga shoqëria "5D", e lidhur me dhe në të cilën mbart interesa kërkuesi Redi Molla (*shih paragrafin 97.3, faqja 87, të vendimit të GJKKO-së së Shkallës së Parë*). Pavarësisht se neni 36, paragrafi 2, i KP-së parashikon se nëse produktet e veprës penale janë bashkuar me pasuri të fituara në rrugë të ligjshme, këto të fundit konfiskohen deri në vlerën e produkteve të veprës penale, në rastin konkret është arsyetuar se nuk ka pengesë

për sekuestrimin e tyre, pavarësisht burimit të vlerës për pjesën tjetër të blerjes, pasi i përket organit të akuzës në vijim të hetimeve të qartësojë nëse e gjithë vlera e tyre vjen si pasojë e transformimit të produktit të tyre të dyshuar të veprës penale, ose që vetëm një pjesë e saj, duke u saktësuar kjo vlerë (*shih paragrafin 97.4, faqja 88, të vendimit të GJKKO-së së Shkallës së Parë*). Lidhur me faktin se këto pasuri të paluajtshme janë në pronësi të prindërve të kërkuesit Redi Molla, pra jo ligjërisht në pronësi të tij, nuk është konsideruar si pengesë për sekuestrimin e tyre, me arsyetimin se ka lidhje të mjaftueshme mes tyre dhe veprave penale objekt procedimi (*shih paragrafin 97.5, faqja 88, të vendimit të GJKKO-së së Shkallës së Parë*). Për këto pasuri, duke qenë se rezultojnë të jenë produkte të prejardhura të veprës penale në kuptim të nenit 36, pika 2, të KP-së, përbëjnë një rrezik real dhe prezent për transferimin e tyre tek të tretët, me qëllim shmangien e konfiskimit. Ky transferim mund të ndodhë në çdo kohë, për sa kohë mbi to nuk rezultojnë të regjistruara kufizime mbi tagrin e disponimit të tyre, duke qenë se janë të regjistruara në emër të të tretëve dhe jo personave nën hetim, duke rënduar kështu pasojat e veprës penale (*shih faqen 90, të vendimit të GJKKO-së së Shkallës së Parë)*.

59. Me të njëjtat argumente edhe GJKKO-ja e Apelit ka arritur në përfundimin se kriteret ligjore të përcaktuara nga neni 274, paragrafi 1, i KPP-së dhe neni 36, pika 1, shkronja "b", i KP-së në lidhje me pikat 2 dhe 3 të atij neni. Ajo gjykatë ka vlerësuar se nga të dhënat deri në atë moment të procedimit penal provohej se pasuritë e sekuestruara e kanë origjinën nga fondet e shoqërisë "5D", për rrjedhojë, sipas saj, nuk ka asnjë dobi vërtetimi i aftësisë paguese të kërkuesve Redi dhe Ollga Molla, ose aftësia e tyre pasurore për të justifikuar vlerën e pasurive të sekuestruara, pasi provohet se secila prej tyre e ka origjinën nga produktet e veprës penale të krijuara të ndër vite nga shoqëria "5D" (*shih faqen 150, të vendimit të GJKKO-së së Apelit*).

60. Ndërsa Gjykata e Lartë ka vlerësuar se gjykatat e faktit kanë arsyetuar për kushtet dhe kriteret për caktimin e masës së sekuestros preventive, duke dhënë vendime në përputhje me nenin 274 të KPP-së, të cilat nuk janë të cenueshme. Lidhur me pretendimet se sekuestroja është vendosur mbi pasuri të një personi që nuk është nën hetim, ajo gjykatë ka arsyetuar se objekt i sekuestrimit mund të jetë edhe një pasuri e një personi që nuk ka lidhje me krimin, për sa kohë që kjo pasuri është e lidhur në mënyrë indirekte me krimin dhe mund të përbëjë rrezik për rëndimin ose zgjatjen e pasojave të veprës penale, ose lehtësimin e kryerjes së fakteve penale të mëtejshme (*shih paragrafët 34–39, të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Po kështu, ajo gjykatë ka vlerësuar se pavarësisht se në dukje gjykata e apelit ka arsyetuar ndryshe nga gjykata e shkallës së parë (kryesisht në cilësimin juridik të faktit penal), në thelb nuk ka asnjë kontradiktë me të dhe me kërkesën e Prokurorisë së Posaçme për ekzistencën e kushteve dhe të nevojave në rastin konkret për caktimin e masës së sekuestros preventive, duke i vlerësuar vendimet e gjykatave të posaçme plotësuese të njëra-tjetrës (*shih paragrafin 40, të vendimit të Gjykatës së Lartë)*.

61. Kërkuesit në ankimin kushtetues individual kanë pretenduar se ndalimi i tjetërsimit të këtyre pasurive, duke bërë shënimet përkatëse në regjistrin e pasurive të paluajtshme do të ishte e mjaftueshme për të arritur qëllimin e synuar nga neni 274 i KPP-së; se kërkuesi Redi Molla, pjesën takuese në pasuritë e paluajtshme e ka fituar si pasojë e trashëgimisë nga i ndjeri, i ati i tij; se Prokuroria e Posaçme nuk ka hetuar dhe gjykatat nuk kanë arsyetuar se ku është dyshimi që këto pasuri mund të jenë krijuar nga produktet e veprës penale, kur origjina e tyre është e qartë. Nuk është verifikuar burimi i të ardhurave të kërkuesit Redi Molla dhe as i familjarëve të tij. Në vendimet gjyqësore nuk arsyetohet se përse është sekuestruar edhe pjesa takuese e kërkueses Ollga Molla, e cila nuk është person nën hetim. Nga ana tjetër, masa është joproporcionale, pasi pagesa e pretenduar prej 100.000 eurosh dhënë nga shoqëria "5D" është bërë vetëm për pasurinë me nr. 5/648, ndaj është e paqartë lidhja dhe përfshirja në sekuestro edhe e pasurisë me nr. 5/523, për të

cilën ka vetëm aludime dhe indicie. Nga analiza financiare e kërkuesve rezulton se burimi i të ardhurave për blerjen e këtyre pasurive të paluajtshme (në shumën 37.218.000 lekë) janë të ardhurat e realizuara nga shitja e pasurisë së paluajtshme nr. 6/257, sipas kontratës nr. 1683 rep., nr. 675 kol., datë 8.4.2019, në shumën 380.000 euro (47.787.000 lekë, konvertuar me kursin e kohës).

62. Për sa më sipër, Gjykata vëren se në rastin konkret masa e sekuestros është vendosur nga gjyqtari i hetimeve paraprake mbi kërkesën e prokurorit, ndërsa vendimi i tij dhe zbatimi i masës në vijim i është nënshtruar kontrollit nga gjykatat më të larta. Vendimet gjyqësore të kundërshtuara përmbajnë informacionin e nevojshëm në lidhje me arsyet e vendosjes dhe të zbatimit të masës së sekuestrimit për pasuritë që janë vlerësuar se përbëjnë produkte të veprave penale objekt procedimi, në përputhje me nenin 274 të KPP-së. Konkretisht, gjykatat kanë arsyetuar lidhur me: i. ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova; ii. lidhjen e mjaftueshme me veprën penale, për pasuritë e paluajtshme në emër të prindërve të kërkuesit Redi Molla; iii. rrezikun se disponimi i lirë i sendit ose i objektit që lidhet me veprën penale mund të rëndojë ose të zgjasë pasojat e veprës *(shih paragrafët 5–7 të vendimit)*. Referuar arsyetimit të vendimeve gjyqësore të kundërshtuara, në drejtim të mënyrës së interpretimit dhe të zbatimit të nenit 274 të KPP-së, si baza ligjore e zbatueshme edhe në rastin konkret, Gjykata çmon se gjykatat e posaçme i kanë dhënë përgjigje kërkuesit për sa u takon pretendimeve për ligjshmërinë dhe proporcionalitetin e masës së sekuestros të vendosur mbi pasuritë e konsideruara se përbëjnë produkte të veprave penale objekt procedimi, duke arsyetuar mjaftueshëm për pretendimet e kërkuesve në këtë drejtim. Arsyetimi i tyre nuk duket të jetë i paarsyeshëm në aspektin kushtetues, në kuptimin që nuk përmban gabime të dukshme ligjore ose faktike.

63. Lidhur me pretendimin se sekuestroja është vendosur mbi pasuri të një personi që nuk është nën hetim, Gjykata e Lartë ka arsyetuar se objekt i sekuestrimit mund të jetë edhe një pasuri e një personi që nuk ka lidhje me krimin, për sa kohë që kjo pasuri është e lidhur në mënyrë indirekte me krimin dhe mund të përbëjë rrezik për rëndimin ose zgjatjen e pasojave të veprës penale, ose lehtësimin e kryerjes së fakteve penale të mëtejshme (*shih paragrafët 34–39, të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Prandaj Gjykata, sikurse ka theksuar edhe në raste të ngjashme (*shih vendimin nr. 33, datë 20.5.2025, të Gjykatës Kushtetuese*), vlerëson se, ashtu sikurse ka arsyetuar edhe Gjykata e Lartë, ky fakt nuk është i rëndësishëm për sa kohë masa e kundërshtuar është vendosur në kuadër të një procedimi penal dhe në funksion të mbarëvajtjes së tij për një pasuri të dyshuar se është e lidhur me veprën penale për të cilën po hetohet.

64. Për të gjitha arsyet e lartpërmendura, Gjykata vlerëson se pretendimi kërkuesve për pasuritë (nr. 5/523 dhe nr. 5/648) të ndodhura në Tiranë nuk është i bazuar.

65. Në lidhje me *shoqërinë "Restur*", përfshirë pasuritë e luajtshme, të paluajtshme dhe të drejtat pasurore të saj mbi 24% të kapitalit të shoqërisë "Mediterranean Investment Group", gjykatat e posaçme kanë vlerësuar se ka vend që të sekuestrohen *si vlerë ekuivalente e produktit të veprave penale* për të cilat procedohet kërkuesi Redi Molla, për aq sa mund të përcaktohet në këtë fazë të procedimit. Në kushtet kur rezulton se shoqëria "Restur" dhe çdo pasuri e saj është në pronësi të kërkuesit Redi Molla, nuk ka pengesë për sekuestrimin e tyre si sende/të drejta që përmbushin vlerën ekuivalente të produktit të veprës penale, në kuptim të nenit 274, paragrafi 2, të KPP-së dhe nenit 36, pika 1, shkronja "ç", të KP-së, duke lënë detyrë që në vijim të hetimeve të saktësohet edhe vlera e produktit në raport me vlerën e sendit /asetit të sekuestruar për të përmbushur vlerën ekuivalente të tij (*shih paragrafin 97.6, faqja 88, të vendimit të GJKKO-së së Shkallës së Parë*). Pavarësisht se kërkuesi Redi Molla është nën masë sigurimi personal, është çmuar se tjetërsimi i të drejtave pasurore mbi këto shoqëri rrezikon të realizohet përmes

përfaqësimit, për sa kohë mbi to nuk rezultojnë të regjistruara kufizime mbi tagrin e disponimit të tyre.

66. GJKKO-ja e Apelit ka vlerësuar se nuk ka asnjë utilitet provues solvabiliteti i kërkuesve Redi dhe Ollga Molla ose aftësia e tyre pasurore për të justifikuar vlerën e pasurive të sekuestruara, pasi provohet se secila prej tyre e ka origjinën nga produktet e veprës penale të krijuara ndër vite nga shoqëria "5D" (*shih faqen 150, të vendimit të GJKKO-së së Apelit*). Ndërsa Gjykata e Lartë, ndonëse nuk është shprehur në mënyrë specifike për sekuestron e vendosur si vlerë ekuivalente të produkteve të veprave penale, ka vlerësuar se gjykatat e faktit kanë arsyetuar në lidhje me kushtet dhe kriteret për caktimin e masës së sekuestros preventive duke dhënë vendime në përputhje me nenin 274 të KPP-së, të cilat nuk janë të cenueshme. Po kështu, ajo gjykatë ka vlerësuar se pavarësisht se në dukje gjykata e apelit ka arsyetuar ndryshe nga gjykata e shkallës së parë (kryesisht në cilësimin juridik të faktit penal), në thelb nuk ka asnjë kontradiktë me të dhe me kërkesën e Prokurorisë së Posaçme për ekzistencën e kushteve dhe të nevojave në rastin konkret për caktimin e masës së sekuestros preventive, duke i vlerësuar vendimet e gjykatave të posaçme plotësuese të njëra-tjetrës (*shih paragrafët 39 dhe 40, të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

67. Kërkuesit kanë pretenduar se qëllimi i synuar nga neni 274 i KPP-së mund të arrihej me masa të tjera më të përshtatshme, si ndalimi i tjetërsimit të këtyre pasurive, duke bërë shënimet përkatëse në regjistrin tregtar. Shoqëria "Restur" është krijuar në datën 1.9.2020, me kapital themeltar në vlerën 100 lekë dhe në harkun kohor 23.9.2020–29.3.2023 nga i ndjeri S. M. kanë kaluar 564.000 euro në llogarinë e shoqërisë. Nga analiza financiare e kërkuesve rezulton se burimi i të ardhurave për investimin e bërë në aktivitetin tregtar, janë: i. të ardhura në vlerën 8.519.635 lekë si kompensim financiar nga Agjencia e Trajtimit të Pronave; ii. të ardhura nga shitja e pasurisë nr. 352/4, sipas kontratës së shitblerjes nr. 3107 rep., nr. 1080 kol., datë 11.8.2020, paguar në dy këste (10.000.000 lekë dhe 20.999.900 lekë); iii. të ardhura nga shitja e pasurisë nr. 102/23+1-5, sipas kontratës së shitblerjes nr. 1469, nr. 998/4 kol., datë 27.6.2019, në shumën 2.232.920 lekë; iv. të ardhura nga shitja e pasurisë truall me nr. pasurie 24/227, sipas kontratës së shitjes nr. 3962 rep., nr. 1375 kol., datë 25.9.2020, në vlerën 150.000 euro (18.615.000 lekë sipas kursit të këmbimit të kohës); v. të ardhura nga shitja e pasurisë nr. 352/4, sipas kontratës së shitblerjes së pasurisë nr. 3107 rep., nr. 1080 kol., datë 11.8.2020, në shumën 20.999.900 lekë; vi. të ardhura nga kthimi i huas, sipas transfertës bankare të datës 28.3.2023, në shumën 75.000 euro (referuar kontratës së huas, datë 28.3.2023, me shtetasin D. K.). Kërkuesit kanë pretenduar se këtë analizë financiare nuk kanë arritur ta paraqesin në gjykatën e apelit për shkak të afatit të shkurtër për të paraqitur ankim, megjithatë e kanë paraqitur së bashku me rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë, me qëllimin për të provuar se prindërit e kërkuesit Redi Molla kanë pasur mundësi financiare për të përballuar investimet për periudhën e analizuar. Për këto pretendime Gjykata e Lartë ka arsyetuar se dalin jashtë juridiksionit të saj, pasi duke qenë të lidhura me analizë provash dhe fakti, janë atribut i gjykatave të faktit.

68. Për sa më sipër, pas shqyrtimit të këtij pretendimi të kërkuesve, në përfundim të diskutimeve, vlerësimet e gjyqtarëve u ndanë në dy qëndrime dhe Gjykata nuk arriti numrin e kërkuar të votave për vendimmarrje, sipas parashikimeve të nenit 133, pika 2, të Kushtetutës, të detajuar edhe në nenin 72, pika 2, të Ligjit Organik të Gjykatës.

69. *Sipas njërit qëndrim*, kërkesa duhej pranuar pjesërisht, pasi pretendimi i kërkuesve për cenimin e të drejtës së pronës në aspektin procedural të saj, në lidhje me masën e sekuestros së vendosur mbi shoqërinë "Restur", me ortak të vetëm kërkuesin Redi Molla, të fituar për shkak të trashëgimisë nga i ati i ndjerë S. M., së bashku me pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme në

pronësi të saj, si dhe kuotën që ajo zotëron në shoqërinë "Mediterranean Investment Group", të barabartë me 24% të kapitalit të kësaj të fundit, të sekuestruara "për ekuivalencë", është i bazuar[1].

70. Konkretisht, për sa i takon përshtatshmërisë së ndërhyrjes, Gjykata ka vlerësuar se masa e sekuestros duhet të jetë e arsyeshme, duke balancuar qëllimin e procedimit penal me interesat e individit të prekur, në kuptimin që ajo nuk duhet të caktohet përtej asaj që është e pashmangshme (*shih vendimin nr. 29, datë 16.4.2024, të Gjykatës Kushtetuese*). Në rastin konkret, sipas këtij qëndrimi, nga përmbajtja e vendimeve gjyqësore të kundërshtuara, për masën e sekuestros të vendosur mbi shoqërinë "Restur", me ortak të vetëm kërkuesin Redi Molla, të fituar për shkak të trashëgimisë nga i ati i ndjerë S. M., së bashku me pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme në pronësi të saj, si dhe kuotën që ajo zotëron në shoqërinë "Mediterranean Investment Group", të barabartë me 24% të kapitalit të kësaj të fundit, të sekuestruara për ekuivalencë, nuk rezulton që gjykatat e posaçme të kenë analizuar nëse qëllimi i parashikuar nga neni 274 i KPP-së mund të arrihej me masa të tjera më pak kufizuese. Ndërkohë, kërkuesit kanë pretenduar se qëllimi i synuar nga kjo masë mund të arrihej, për shembull, nëpërmjet vendosjes së kufizimeve për tjetërsimin e tyre në regjistrat përkatës publikë, masë që, sipas tyre, do të ishte më proporcionale. Për më tepër, GJKKO-ja e Apelit e ka konsideruar të panevojshëm verifikimin e aftësive paguese të kërkuesve për të justifikuar vlerën e pasurive të sekuestruara, me arsyetimin se secila prej tyre e ka origjinën nga produktet e veprës penale të krijuara ndër vite nga shoqëria "5D". Nga ana tjetër, Gjykata e Lartë e ka gjetur të pabazuar pretendimin e kërkuesve për shpërpjesëtimin e masës, duke arsyetuar se, në rrethanat e rastit konkret, kufizimi i të drejtave kushtetuese për shkak të vendosjes së masës së sigurimit të karakterit pasuror është rrjedhojë e një baraspeshimi të drejtë midis interesit publik dhe të drejtave themelore kushtetuese individuale të personave/subjekteve të prekur nga ndërhyrja, si dhe se shkaqet e paraqitura në rekurs nuk evidentojnë që masat e caktuara ndaj pasurive në fjalë të jenë dukshëm arbitrare ose joproporcionale.

71. Për sa më sipër, sipas këtij qëndrimi, nuk rezulton se gjykatat e posaçme kanë arsyetuar në mënyrë të mjaftueshme lidhur me elementin e përshtatshmërisë së ndërhyrjes së masës së sekuestros preventive të vendosur mbi shoqërinë "Restur", me ortak të vetëm kërkuesin Redi Molla, të fituar për shkak të trashëgimisë nga i ati i ndjerë S. M., së bashku me pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme në pronësi të saj, si dhe kuotën që ajo zotëron në shoqërinë "Mediterranean Investment Group", të barabartë me 24% të kapitalit të kësaj të fundit, të sekuestruara për ekuivalencë mbi pasuritë e kërkuesve. Madje, GJKKO-ja e Apelit ka refuzuar të marrë në shqyrtim pretendimet e kërkuesve lidhur me aftësitë paguese, që, sipas tyre, do të vërtetonin se ata i justifikonin me të ardhura të ligjshme pasuritë e sekuestruara, duke arritur *apriori* dhe pa ndonjë analizë konkrete në përfundimin se secila prej pasurive të sekuestruara e ka origjinën nga produktet e veprës penale të krijuara ndër vite nga shoqëria "5D". Edhe Gjykata e Lartë, ndonëse formalisht e ka marrë në shqyrtim këtë pretendim të kërkuesve, duke arsyetuar se masa është rrjedhojë e një baraspeshimi të drejtë midis interesit publik dhe të drejtave individuale të personave/subjekteve të prekur nga ajo, nuk rezulton t'i jetë përgjigjur pretendimit se përse qëllimi i synuar nga kjo masë nuk mund të arrihej, për shembull, nëpërmjet vendosjes së kufizimeve për tjetërsimin e tyre në regjistrat përkatës publikë, që do të ishte një masë më proporcionale.

72. Ndërsa në drejtim të ashpërsisë së ndërhyrjes, Gjykata ka pohuar se gjykatat e zakonshme, në çdo rast, duke pasur në vëmendje si mbrojtjen e të drejtave kushtetuese të individit, ashtu edhe standardet e evidentuara në jurisprudencën kushtetuese, me qëllim garantimin e së drejtës për një gjykim të drejtë, duhet të bëjnë kujdes për të arsyetuar në mënyrë të plotë dhe shteruese

[1] Votuan sipas këtij qëndrimi gjyqtarët Fiona Papajorgji, Sandër Beci, Ilir Toska dhe Genti Ibrahimi.

respektimin e këtij kriteri në drejtim të secilit prej tagrave të së drejtës së pronës së individit ndaj të cilit vendoset kufizimi i pasurisë (*shih vendimin nr. 33, datë 20.5.2025, të Gjykatës Kushtetuese*). Duhet ritheksuar se për masën e sekuestros "për ekuivalencë" – si një masë që shtrihet mbi sende të tjera, të ndryshme nga sendi ose produktet e veprës penale, pra sende për të cilat, nuk verifikohet dhe as nuk certifikohet në atë procedim penal ligjshmëria e burimit të tyre - Gjykata është shprehur se duhet të synohet të preken sa më pak tagra të sendit, në mënyrë që kjo masë, nga njëra anë, të jetë sa më pak e dëmshme për individin dhe, nga ana tjetër, të sigurojë qëllimin e saj, që është shmangia e tjetërsimit/humbjes së sendeve në pritje të përfundimit të procesit penal. Në këtë kuptim, gjykatat e zakonshme duhet të tregojnë kujdes në zbatimin e nenit 274 të KPP-së të lidhur me nenin 36, pika 1, shkronja "ç", të KP-së, duke bërë, për aq sa është e mundur, vlerësimin e mënyrës së zbatimit të këtyre dispozitave në drejtim të ekuivalencës me produktet e dyshuara të veprës penale (*shih vendimin nr. 20, datë 11.4.2025, të Gjykatës Kushtetuese)*.

73. Një analizë e analizë e tillë mbi tagrat që synohen të preken apo kufizohen në kuptim të proporcionalitetit të ndërhyrjes, mungon në vendimet gjyqësore objekt gjykimi. Edhe pse me anë të vendosjes së këtyre pasurive nën administrimin e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara nënkuptohet se kërkuesve u janë kufizuar të tri tagrat e pronësisë, sipas këtij qëndrimi, vendimet gjyqësore të kundërshtuara nuk rezulton të kenë arsyetuar mjaftueshëm në përputhje me jurisprudencën kushtetuese, për pamundësinë e arritjes së të njëjtit rezultat me një ndërhyrje më pak kufizuese, si për sa i përket shtrirjes së saj në sendet dhe pasuritë që do të preken, ashtu edhe në tagrat e vetë së drejtës substanciale të pronës private. Në këto kushte, në mungesë të arsyetimit të këtij elementi nga gjykatat e posaçme dhe të riparimit të kësaj mangësie nga Gjykata e Lartë, është e pamundur të verifikohet nëse masa e sekuestros preventive, e vendosur mbi pasuritë që përbëjnë vlerën ekuivalente të asaj që dyshohet se është përfituar nga veprat penale (mbi shoqërinë "Restur", me ortak të vetëm kërkuesin Redi Molla, të fituar për shkak të trashëgimisë nga i ati i ndjerë S. M., së bashku me pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme në pronësi të saj, si dhe kuotën që ajo zotëron në shoqërinë "Mediterranean Investment Group", të barabartë me 24% të kapitalit të kësaj të fundit), e tejkalon ose jo kriterin e ashpërsisë së masës në rastin konkret, në kuptimin që të verifikohet nëse qëllimi që synohet të arrihet mund të përmbushej edhe përmes kufizimit vetëm të njërit ose disa prej tagrave të së drejtës së pronës.

74. Për sa më sipër, vendimet e gjykatave të posaçme nuk janë arsyetuar në mënyrë të mjaftueshme sa i takon respektimit të kritereve që lejojnë ndërhyrjen në të drejtën kushtetuese të pronës private, konkretisht në drejtim të përshtatshmërinë dhe ashpërsisë së ndërhyrjes. Kjo mangësi në arsyetimin e këtyre gjykatave nuk është riparuar as nga Gjykata e Lartë në zbatim të parimit të *subsidiaritetit,* sipas të cilit kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese është funksion edhe i Gjykatës së Lartë.

75. Në përfundim, sipas këtij qëndrimi, mënyra se si gjykatat e zakonshme kanë vlerësuar kërkesën e Prokurorisë së Posaçme për caktimin e masës së sekuestros për ekuivalencë dhe mënyra se si kanë zbatuar parashikimet e nenit 36 të KP-së, pa dhënë një arsyetim të mjaftueshëm për përshtatshmërinë dhe ashpërsinë e ndërhyrjes, ka sjellë një rezultat arbitrar në të drejtën kushtetuese të pronës private, duke i bërë këto vendime të papajtueshme me Kushtetutën. Për rrjedhojë, kërkesa duhej pranuar pjesërisht dhe Gjykata duhej të vendoste shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Lartë dhe të vendimit të GJKKO-së së Apelit, vetëm për sa i përket disponimit për sekuestron e vendosur mbi shoqërinë "Restur", me ortak të vetëm kërkuesin Redi Molla, të fituar për shkak të trashëgimisë nga i ati i ndjerë S. M., së bashku me pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme në pronësi të saj, si dhe kuotën që ajo zotëron në shoqërinë "Mediterranean Investment

Group", të barabartë me 24% të kapitalit të kësaj të fundit, që përbëjnë, sipas tyre, vlerën ekuivalente të asaj që dyshohet se është përfituar nga veprat penale, duke ia dërguar këtë pjesë të çështjes për shqyrtim GJKKO-së së Apelit, e cila, si gjykatë fakti dhe ligji, mund të korrigjonte shkeljen e konstatuar që lidhet me pamjaftueshmërinë e arsyetimit për elemente që kërkojnë vlerësim të faktit dhe të ligjit, duke u kujdesur që të arsyetonte për sa më sipër, për të garantuar një proces të rregullt gjyqësor në respektim të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe së drejtës për pronë private.

76. Ndërsa *sipas qëndrimit tjetër*, pretendimi i kërkuesve për cenimin e së drejtës së pronës në aspektin procedural të saj është i pabazuar, sepse gjykatat kanë arsyetuar mjaftueshëm në lidhje me nevojën e vendosjes së sekuestros preventive me ekuivalencë.[2]

77. Sipas këtij qëndrimi, neni 36, pika 1, shkronja "ç", i KP-së dhe neni 274, pika 2, i KPP-së lejojnë shprehimisht sekuestrimin e çdo pasurie tjetër (*pasuri ekuivalente*), vlera e së cilave i korrespondon asaj të produkteve të veprës penale. Nuk është e paarsyeshme vendimmarrja e gjykatave që për sa kohë që në fazën fillestare të hetimit, nuk mund të përcaktoheshin ende me siguri përmasat e "produkteve të veprave penale", si dhe pasuritë në fjalë lidheshin drejtpërdrejt me personin nën hetim Redi Molla, ato të mund të bëheshin objekt i sekuestros preventive. Sipas nenit 41, pika 3, të Kushtetutës, kufizimi mbi të drejtën e pronës për sa i përket shoqërisë "Restur", tek e cila kishte interesa ekonomikë kërkuesi tjetër Redi Molla (njëkohësisht i pandehur), përbën kufizim me ligj i ushtrimit të së drejtës së pronës, që synon të mbrojë interesin publik, të garantimit të mundësisë së konfiskimit eventual të produkteve të veprës penale ose vlerës ekuivalente të tyre. Ky interes publik në fazën fillestare të vendosjes së sekuestros, mbizotëron mbi interesat privatë që lidhen me mbrojtjen e pronësisë së *shoqërisë "Restur*", për sa u përket pasurive të luajtshme, të paluajtshme dhe të drejtat pasurore të saj mbi 24% të kapitalit të shoqërisë "Mediterranean Investment Group". Sipas nenit 274, pika 3, të KPP-së, sekuestroja preventive mund të hiqet në çdo kohë kur ndryshojnë kushtet e zbatimit. Në rastin e pasurive ekuivalente, nëse gjenden pasuri që identifikohen si produkte të veprës penale, sekuestroja mund të vihet mbi to dhe të hiqet nga pasuritë ekuivalente të sekuestruara, kur vlerësohet se mbajtja e tyre në sekuestro nuk plotëson nevojat e parashikuara nga neni 36 i KP-së. Porse, në fazën fillestare të hetimit, veprimet e Prokurorisë së Posaçme dhe të gjykatave të zakonshme, nuk janë arbitrare, por kanë kryer një kufizim të përkohshëm të tagrave të pronësisë, që synon mbrojtjen e interesit publik dhe që nuk është joproporcional për sa i përket masës së marrë dhe interesit që synohet të mbrohet.

78. Pretendimi i kërkuesve në lidhje me modalitetet e vendosjes së sekuestros preventive, e cila, sipas tyre, duhej të realizohej përmes vendosjes së shënimeve në regjistrat publikë për ndalimin e tjetërsimit, gjë e cila, sipas tyre, do të ishte më pak kufizuese, nuk gjen mbështetje në ligj dhe për më tepër nuk mbështet ndonjë argument me natyrë kushtetuese të kërkuesit. Edhe pse në vendimet gjyqësore objekt gjykimi mungon një analizë në lidhje me nënkriterin e ashpërsisë së masës në raport me të tre tagrat e së drejtës së pronës, bazuar në rrethanat e çështjes konkrete dhe referuar qëllimit e pasojave të masës së sekuestros preventive, sikundër ato janë pranuar nga gjykatat e zakonshme, vlerësohet se masa në rastin konkret nuk tejkalon kriterin e ashpërsisë. Sekuestroja preventive në dallim nga sekuestroja konservative (e cila zbatohet nga përmbaruesi sipas rregullave të KPC-së), administrohet sipas ligjit nr. 34/2019, "Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara", të ndryshuar. Kjo do të thotë se sipas nenit 4, shkronja "c", e vijues të ligjit, ekzekutimi i sekuestros preventive bëhet sipas ligjit të posaçëm që parashikon edhe marrjen në administrim të pasurive të sekuestruara, duke mos u mjaftuar vetëm te bërja e

[2] Votuan sipas këtij qëndrimi gjyqtarët Marsida Xhaferllari, Marjana Semini dhe Asim Vokshi.

shënimeve në regjistrat publikë për sekuestron e sendeve të regjistrueshme në regjistra publikë. Në këtë kuptim, edhe pse kufizimi ka prekur të gjitha tagrat e pronësisë, konsiderohet se midis vendimit të sekuestros dhe qëllimit të ndjekur duket se ka një marrëdhënie të arsyeshme proporcionaliteti, prandaj kufizimi i së drejtës së pronës është në raport të drejtë me gjendjen që e ka diktuar atë dhe është bërë në zbatim të rregullave të parashikuara në ligj, që synojnë të mbrojnë interesin publik. Në këtë situatë reale dhe faktike, masa e kundërshtuar, e cila ka kufizuar jo vetëm tagrin e disponimit, por edhe atë të gëzimit, konsiderohet se është proporcionale në drejtim të ashpërsisë së saj.

79. Për sa më sipër, duhet mbajtur në konsideratë edhe hapësira e gjerë e vlerësimit të autoriteteve në ndjekjen e politikave penale në luftën kundër kriminalitetit, veçanërisht kur bëhet fjalë për vepra të tilla penale të rënda, që prekin drejtpërdrejt interesin publik. Veprat penale konkrete i kundërdrejtohen autoritetit të shtetit, pasi kanë të bëjnë me veprime të punonjësve shtetërorë, që në vend që të ushtrojnë shërbimin publik, kryejnë veprime për të dëmtuar veprimtarinë shtetërore për qëllime të përfitimit personal. Për këtë arsye, vlerësohet se procedurat, në tërësinë e tyre, kanë respektuar ekuilibrin e drejtë të kërkuar. Po kështu, vërehet se kërkuesve u është dhënë një mundësi e arsyeshme për të paraqitur argumentet e tyre përpara gjykatave të zakonshme dhe ata kanë pasur akses në dy nivele juridiksioni, ndërsa janë përfaqësuar nga avokat i zgjedhur prej tyre. Në këtë mënyrë, kërkuesve u është dhënë mundësia për të paraqitur çështjen e tyre në procedura kontradiktore përpara gjykatave të zakonshme, të cilat u kanë dhënë përgjigje pretendimeve të tyre për caktimin e masës së kundërshtuar, arsyetim ky që nuk duket të jetë arbitrar ose të mos plotësojë kërkesat e një gjykimi të drejtë. Ndaj edhe kjo pjesë e kërkimeve nuk duhej pranuar nga Gjykata, e cila, siç ka theksuar në jurisprudencën e saj konstante, nuk është shkallë e katërt e gjyqësorit të zakonshëm (*shih vendimet nr. 59, datë 14.11.2023; nr. 30, datë 29.5.2023; nr. 29, datë 1.11.2022, të Gjykatës Kushtetuese*), por mbikëqyr vetëm kushtetutshmërinë e veprimtarisë gjyqësore, e cila, në rastin konkret, nuk rezulton të ketë cenuar parametrat kushtetues.

80. Për shkak të qëndrimeve të mësipërme, Gjykata çmon se në kushtet kur nuk u formua shumica prej 5 gjyqtarësh, në kuptim të nenit 73, pika 4, të Ligjit Organik të Gjykatës, kërkesa e kërkuesve konsiderohet e rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f", 133, pika 2, shkronja "i", dhe 134, pika 1, të Kushtetutës, si dhe neneve 71, 72 dhe 73, pika 4, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.
Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 21.4.2026.
Shpallur më 17.6.2026.

Kryetare: Fiona Papajorgji

Anëtarë: Sandër Beci, Marsida Xhaferllari, Genti Ibrahimi, Ilir Toska, Asim Vokshi, Marjana Semini